

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7153
E enjte, 28 mars 2024
Çmimi 0.50

Lukas Mandl bën
thirrje për zbatim të
marrëveshjeve të
Brukselit dhe Ohrit

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



**OSMANI: AMBICIET IMPERIALISTE
TË RUSISË MUND TË SHTRIHEN
NË BALLKAN** F. 2

**HEZBOLLAHU SULMON ME RAKETA
VERIUN E IZRAELIT** F. 2




EKONOMI



**MBËSHKETJA PËR BIZNESET,
MINT LANSON THIRRJE PUBLIKE
NË VLERË 2.5 MILIONË EURO** F. 8

**ATK-ja U BËNË THIRRJE
TATIMPAGUESVE T'I RAPORTOJNË
SPONSORIMET** F. 8

SPORT



**ZHEGROVA DHE VOJVODA: GABIMET
NA KUSHTUAN ME HUMBJE** F. 12

BEDRI HAMZA, KANDIDAT I PDK-së PËR KRYEMINISTËR TË KOSOVËS

FAQE 5



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka nominuar Bedri Hamzën kandidat të PDK-së për kryeministër të

Kosovës. "Si një personalitet i dëshmuar, Bedriu është përgjigjja jonë ndaj thirrjeve të qytetarëve për jetë, mirëqenie dhe të ardhme

më të mirë e më të sigurt!", ka thënë Krasniqi të mërkurën në një konferencë të përbashkët për medie me Bedri Hamzën

**HOVENIERI: INTEGRIMI EVROPIAN
DHE EUROATLANTIK I KOSOVËS,
URGJENCË E QARTË** F. 7



**BYRNES: S'KEMI PASUR
PROVA QË TREGONIN SE
SHTABI I PËRGJITHSHËM
I UÇK-SË KISHTE
URDHËRUAR RRËMBIME
DHE NDALIME** F. 3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Osmani: Ambiciet imperialiste të Rusisë mund të shtrihen në Ballkan

SHKUP, 27 MARS - Ukraina është vetëm ndalesa e parë e ambicieve imperialiste të Rusisë, deklaroi të mërkurën ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani. Sipas tij, pas Ukrainës, agresioni rus pritet të përhapet edhe në vende të tjera të Evropës Lindore, përfshirë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Këto komente Osmani i bëri në një takim në Shkup me ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së dhe NATO-s, me rastin e shënimit të katërvjetorit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në Aleancën Veriatlantike. “Rajoni gjithnjë e më shumë po bëhet fushë për garë gjeopolitike. Ballkani Perëndimor është në vijën e zjarrit mes Perëndimit dhe Lindjes, mes demokracisë dhe autoritarizmit. Agresioni ushtarak rus ndaj Ukrainës tregoi se arkitektura ushtarake e sigurisë në Evropë është prishur dhe ashtu siç kam thënë edhe në raste të tjera, Ukraina është ndalesa e parë e ambicieve imperialiste të Rusisë. Pas Ukrainës, agresioni rus pritet të përhapet edhe më tej në Lindje drejt Moldavisë, Kaukazit, Gjeorgjisë dhe besoj se stacioni i radhës do të jenë shtetet e Ballkanit Perëndimor”, tha ministri Osmani.

Sipas tij, agresioni rus nuk paraqet vetëm sulm direkt ndaj Ukrainës, por edhe sfidë mbi të drejtën ndërkombëtare, vlerat dhe normat që sollën prosperitet dhe siguri në Evropë.

Osmani theksoi se në një situatë të tillë të kërcënimeve mbi paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë, integrimet

evropiane dhe euroatlantike duhet të jenë prioritet për demokracitë perëndimore. “Tani, si asnjëherë më parë, integrimi evropian dhe euroatlantik i Ballkanit Perëndimor duhet të konsiderohet si një mjet i fuqishëm për përmirësimin e sigurisë dhe konsolidimin e stabilitetit të krahut juglindor të NATO-së”, u shpreh ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut.

Ambasadorja e Ukrainës në Shkup, Larisa Dir, në fjalimin e saj theksoi nevojën e anëtarësimit të vendit të saj në NATO dhe BE, por edhe nevojën për më shumë ndihmë ushtarake për përballje me agresionin rus.

Diplomatja ukrainase tha se “edhe pa qenë anëtare e NATO-s, por duke i ndarë njëkohësisht vlerat e saj tash e katër vjet me radhë, Ukraina ka dëshmuar rezistencë ndaj agresionit brutal të Kremlinit që ka tronditur botën demokratike”. “Ukraina tashmë është pjesë integrale e sigurisë euroatlantike. Ne nuk jemi pjesë e Aleancës, por Ukraina de-facto po e mbron krahun lindor të NATO-s. Anëtarësimi i Ukrainës në NATO dhe në BE duhet të jenë pjesë e fitores sonë të përbashkët për kthimin e integritetit territorial të Ukrainës dhe gjykimin e Rusisë për të gjitha krimet kundër njerëzisë”, tha ambasadorja Dir.

Ambasadori i Bashkimit Evropian, David Geer, tha se BE-ja mbetet e përkushtuar që së bashku me NATO-n të bëjnë gjithçka për ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit në Evropë dhe më gjerë. Sipas tij,



kërcënimi më i madh për komunitetin euroatlantik mbetet brutaliteti rus, dhuna dhe shkelja e të drejtave të njeriut dhe e marrëveshjeve ndërkombëtare, gjë që u dëshmuar me agresionin në Ukrainë, pasojat e të cilit po i ndiejnë miliarda njerëz në botë. “NATO-ja mbetet themeli i mbrojtjes kolektive të aleatëve dhe i sigurisë euroatlantike. NATO-ja dhe BE-ja njëkohësisht luajnë një rol komplementar në forcimin dhe mbështetjen e paqes. Që nga agresioni rus në Ukrainë raportet e NATO-s me BE-në

janë forcuar përmes partneritetit strategjik, përfshirë edhe aktivitetet për mbrojtje kundër sulmeve kibernetike. Rruga drejt BE-së është rrugë drejt prosperitetit dhe forcimit të vlerave demokratike”, tha ambasadori Geer.

Ai theksoi se unioni mbështet aspiratat e Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në BE, pasi nga kjo, sipas tij, të gjithë do të kenë përfitime. Prandaj, ai inkurajoi Shkupin të bëjë gjithçka për t’u anëtarësuar në union. Që kjo të ndodhë, Geer tha se Maqedonia e Veriut

duhet t’i përmbushë kriteret që i ka si obligim që nga qershori i vitit 2022 e që kanë të bëjnë me ndryshimin e Kushtetutës për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj, bazuar në atë që njihet si “Propozim francez” për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Bullgarinë.

Maqedonia e Veriut është bërë anëtare e NATO-s më 27 mars të vitit 2020 pas një rrugëtimi të gjatë për shkak të bllokimit të Greqisë, e cila hoqi veton pas ndryshimit të emrit Maqedoni në Maqedoni të Veriut në vitin 2018.

Hezbollahu sulmon me raketa veriun e Izraelit



BEJRUT, 27 MARS - Rreth 30 raketa u lëshuan nga Libani drejt veriut të Izraelit mëngjesin e 27 marsit, tha ushtria izraelite. Grupi militant, Hezbollah, mori përsipër lëshimin e raketave dhe tha se ky veprim ishte në përgjigje të një sulmi ajror izraelit gjatë natës ndaj një qendër mjekësore, të lidhur me këtë grup, në jug të Libanit, kur u vranë shtatë anëtarë të Hezbollahut.

Grupi militant libanez Hezbollah nisi sulmet raketore drejt Izraelit një ditë pasi nisi lufta midis Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në Gazë më 7 tetor. Që atëherë Hezbollahu dhe Izraeli kanë këmbyer zjarr

pothuajse çdo ditë, kryesisht në zonën përgjatë kufirit Liban - Izrael, përderisa ndërmjetësit ndërkombëtarë po tentojnë të parandalojnë një luftë në shkallë të plotë në mes të Izraelit dhe Hezbollahut.

Sulmet me raketa të Hezbollahut u kryen në qytetin verior izraelit të Kirjat Shmona dhe ndaj një baze ushtarake që ndodhet në këtë qytet.

Ekipet e shpëtimit në Izrael thanë se një 25-vjeçar u vra nga sulmet e Hezbollahut, ndërsa një person është plagosur.

Që kur ka shpërthyer dhuna në mes të Hezbollahut dhe Izraelit, nga luftimet janë vrarë nëntë civilë dhe 11 ushtarë në Izrael. Ndërkaq, pothuajse 240 luftëtarë të Hezbollahut dhe afër 40 civilë janë vrarë në Liban.

Byrnes: S'kemi pasur prova që tregonin se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte urdhëruar rrëmbime dhe ndalime



HAGË, 27 MARS - Gjatë dëshmisë së tij në Hagë të mërkurën, ish-diplomati amerikan, Shaun Byrnes, tha se nuk kanë pasur asnjëherë prova që tregonin se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte dhënë urdhër për rrëmbime apo ndalime të dikujt. “Me lejoni që të jem tejet i saktë dhe i qartë. Ne as edhe njëherë nuk kemi pasur ndonjë provë që të tregonte se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Thaçi, Krasniqi, Ramë Buja, Xhaviti e të tjerë. Kurrë nuk kemi pasur prova që ata të kenë dhënë urdhër apo të udhëzonin që të merreshin pengë, të rrëmbeshin gazetarët serbë apo aktivistët e LDK-së. Kurrë nuk kemi pasur prova të tilla, apo për ndonjë civil”, tha Byrnes gjatë përgjigjeve në kundërpjetet e avokatit të Veselit, Ben Emmerson.

Ai tha se kanë menduar se këto veprime ndërmerreshin në formë të pavarur nga komandantët e zonave ose brigadave. “Më lejoni ta mbaroj përgjigjen time! Sigurisht që ne menduam që këto veprime, pra prezumimi im ishte ky, që këto veprime ndërmerreshin ose në

formë të pavarur nga komandantët vendas të UÇK-së ose eprorët e tyre, pra për shembull komandanti i Brigadës ose i Zonës”, tha ai.

Dëshmitari u pajtua që nuk ishte domosdoshmërisht në nivel të komandantit të zonës, por që mund të ishin edhe persona të pabindur më poshtë së komandantit të zonës që merrnin këto vendime, por që nuk merreshin më lart se niveli i zonës. “Po. Por ne nuk e dinim këtë. Por edhe njëherë, ne nuk kemi parë prova që ishte Shtabi i Përgjithshëm ai që po jepte urdhër për rrëmbimin e këtij civil apo të një aktivisti të LDK-së apo tjetri”, tha Byrnes.

Më tutje Emmersoni e pyeti dëshmitarin se në bazë të njohurive që kishte ai me atë se çfarë po ndodhte në Kosovë, a kishin parë prova që mund ta mbështesnin propozimin që stafi i përgjithshëm kishte përgjegjësi komandues mbi ndalimet në zona dhe fuqi për t'i parandaluar këto veprime. “Ishte një pyetje e ndërlikuar, por përgjigja ime e saktë është jo”, u përgjigj Byrnes në pyetjet e avokatit Emmerson.

Ish-diplomati amerikan thotë se UÇK-ja nuk arriti asnjëherë të ketë një strukturë të unifikuar të ushtrisë

Ish-diplomati amerikan Shaun Byrnes pohoi se është e drejtë të thuhet se UÇK-ja nuk arriti ta ketë asnjëherë një strukturë të unifikuar të ushtrisë. Ky vlerësim i Byrnes erdhi gjatë përgjigjeve në kundërpjetet e avokatit të Veselit, Ben Emmerson.

Sa i takon rolin të Veselit ai tha se funksioni i tij ishte si Ministri e Jashtme që duhej të komunikonte me ndërkombëtarët dhe ishte pjesë e një grupi që punonte në diasporë. “Më sa kisha kuptuar unë, ai ka qenë pjesë e këtij grupi. Grupi i personave që punoi në diasporë, kryesisht në Zvicër. Xhavit Haliu ishte një prej personave të tjerë dhe shumë të tjerë syresh të cilët udhëheqja e LPK-së kishte vendosur t'i rikthente në rajon në mënyrë që të shfrytëzonin këto mundësi që në njëfarë forme të krijonin njëfarë udhëheqje - udhëheqje politike. Udhëheqje ndaj policisë rajonale.

Pra, në thelb kjo ishte analiza jonë”, tha ai.

Byrnes tha se nga këta persona që, sipas tij, kanë qenë të pabindur, përpqeshin të krijonin një ushtri koherente që mund të kontrollohej dhe përfaqësohej. “Ne besonim dhe përpqeshim që nga këta persona të pabindur, nga kjo milici, të krijonim një ushtri koherente, tamam një ushtri që ishte në gjendje të kontrollohej dhe të përfaqësohej prej tyre përpara komunitetit ndërkombëtar”, tha ai. Ndërsa për UÇK-në në tërësi pohoi se në thelb mbetet një grup i personave të pabindur që drejtohehin nga komandantët e zonave të cilët kishin shumë pak kontroll nga Shtabi i Përgjithshëm. “Po. Por, do të shtoj diçka që, në fakt, është analiza ime, që mund ta kem pasuruar me informacione, që i kam marrë pas luftës nga persona që dinin më shumë seç dija unë, persona të zonës që dinin më shumë seç dija unë. Po i referohem si zona të milicisë unë këtyre. Kishin marrëdhënie të ndryshme me shtabin e UÇK-së”, tha Byrnes.

Ai tha se këto marrëdhënie vareshin nga burimet që kishin

zonat, raporton “Betimi për Drejtësi”. “Këto marrëdhënie vareshin në burimet, veçanërisht më kanë thënë edhe disa prej kolegëve të mi, që iu kanë thënë se komandantët e zonave si Ramush Haradinaj, Remi në zonën e Llapit, se ata kishin burimet e veta. Kishin vetëfinancim që u vinte nga donatorët. Nuk e di se kush ishin këta dhe nga ishin, por kishin armë në zonën e Llapit. Veçanërisht, Remi dhe zëvendësi i tij, Nuredin Ibishi, na kanë thënë se ata i blinin armët nga një kolonel në Nish. Disa nga zonat e tjera nuk i kishin të njëjtat mundësi. Qoftë për shkak të vendndodhjes gjeografike apo që nuk kishin financim nga donatorët. Pra, zonat e pasura ishin më të pavarura dhe më të shkëputura nga Shtabi i Përgjithshëm”, tha ai.

Ai pohoi se funksioni i dyfishtë mendonin që kishte ky grup në të cilin përshihej edhe Veseli e që ishin dërguar në Kosovë që të krijonin një strukturë komanduese qendrore e që nuk u arrit asnjëherë dhe varej më shumë nga zonat. “Unë do të thosha që deri në mars të 1999-s të paktën ngeli në punë e sipër kjo gjë”, tha dëshmitari.



NË PRISHTINË ËSHTË PËRMBYLLUR TAKIMI I 11-TË I KOMISIONIT
PARLAMENTAR PËR STABILIZIM ASOCIIM BE - KOSOVË

Lukas Mandl bën thirrje për zbatim të marrëveshjeve të Brukselit dhe Ohrit

Lukas Mandl, bashkëkryesues i Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, ka bërë thirrje për zbatim të plotë të marrëveshjeve të Brukselit dhe Ohrit, ndërsa ka përkujtuar se Parlamenti Evropian ka kërkuar heqjen e masave ndaj Kosovës. Sipas tij, dialogu Kosovë - Serbi do të ketë kuptim vetëm kur të mbahet në frymën e mirëbesimit dhe të kompromisit për të arritur një marrëveshje ligjërish të obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 MARS - Të mërkurën është përmbyllur takimi i 11-të i Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociim BE - Kosovë. Në drejtimin e bashkëkryesuesve, Mimoza Kusari-Lila dhe Lukas Mandl, ky sesion trajtoi një varg temash që lidheshin me zhvillimet aktuale në Kosovë dhe perspektivën e saj euroatlantike. Në fjalën e tij para anëtarëve të këtij komisioni, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, vlerësoi rolin e BE-së për nxitjen e bashkëpunimit rajonal, promovimin e rritjes ekonomike dhe mbështetjen e shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut, duke shprehur përkushtimin për të punuar së bashku për adresimin e sfidave dhe avancimin e mëtejshëm të integritetit të Kosovës në BE.

Duke përmendur sfidat që Kosova ka para vetes, Konjufca theksoi nevojën e vazhdimin të zbatimit të reformave në lidhje me sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut. “Ne kemi treguar tashmë përkushtimin tonë për ta forcuar qeverisjen demokratike dhe për të siguruar që institucionet tona të jenë transparente, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është një komponent i rëndësishëm i bashkëpunimit tonë rajonal. Ne jemi të përkushtuar të punojmë së bashku për t'i zgjidhur çështjet e pazgjidhura dhe për ta promovuar paqen dhe stabilitetin në rajon. Ne besojmë se njohja reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë është pjesa thelbësore e marrëveshjes përfundimtare gjithëpërfshirëse, si një parakusht i

domosdoshëm që të dyja vendet të përparojnë në rrugët e tyre evropiane”, ka theksuar Konjufca, duke shtuar se përkushtimi i palëkundur i Kosovës për anëtarësimin në BE qëndron si një fanar i shpresës, duke reflektuar aspiratat e qytetarëve të saj për demokraci dhe prosperitet. Kreu i Kuvendit tha se aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE ishte dhe vazhdon të jetë një moment historik, i rëndësishëm, drejt integritetit më të thellë, duke theksuar respektimin e kriterëve të Kopenhagës dhe vlerave evropiane. Konjufca potencoi se miratimi i kërkesës së Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës nënvizon përkushtimin e vendit ndaj bashkëpunimit dhe integritetit ndërkombëtar. Të drejtat themelore, veçanërisht të drejtat e pakicave dhe grave,

sipas tij, janë parime themelore të përkushtimit të Kosovës për barazi dhe gjithëpërfshirje. Ai tha se strategjitë që synojnë avancimin e të drejtave të komuniteteve pakicë janë shembull i përkushtimit të vendosur të Kosovës për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë individët, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjinia apo orientimi seksual. “Si përfundim, Kosova mbetet e palëkundur në përpjekjet e saj për integrim evropian, demokraci dhe barazi. Ne besojmë se BE-ja nuk është e plotë pa Ballkanin Perëndimor dhe u bëjmë thirrje vendeve anëtare të BE-së t'i japin përparësi zgjerimit dhe t'i japin përfitimet e premtuara pasi të jenë plotësuar kushtet”, tha Konjufca. Bashkëkryesuesja e KPSA-së, Mimoza Kusari-Lila, këtë takim e konsideroi një moment të rëndësishëm në rrugëtimin e Kosovës drejt integriteteve evropiane. Duke kujtuar masakrat që shteti i Serbisë kreu mbi popullatën e pafajshme civile shqiptare dhe bombardimet e NATO-s mbi ish-Jugosllavinë, në 25-vjetorin e tyre, Kusari-Lila tha se duke parë luftën kaq afër nesh, në Evropë, na kujtohet sasia e punës që

duhet bërë të gjithë për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin. “Duke pasur parasysh se viti 2024 është vit zgjedhor për Parlamentin Evropian dhe zgjedhjet janë në afërsi, ju duke qenë këtu me ne, flet me zë të lartë për angazhimin tuaj të palëkundur për zgjerimin e BE-së dhe për qëndrimin pranë Kosovës në këto momente të rëndësishme dhe vlerësimitin e hapave që po bëjmë, duke shkruar drejt integritetit në BE”, theksoi bashkëkryesuesja Mimoza Kusari-Lila. Ajo kujtoi edhe njëherë sulmin terrorist nga grupi paramilitar i Serbisë në veri të Kosovës dhe vrasjen e majorit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, akt ky i cili, siç tha ajo, nxori në dritë fytyrën dhe synimin e vërtetë të Serbisë, për ta penguar komunitetin serb në Kosovë të integrohet dhe për ta sulmuar dhe destabilizuar jo vetëm Kosovën, por paqen dhe sigurinë në mbarë rajonin. Kusari-Lila tha se komuniteti ndërkombëtar e ka marrë parasysh përparimin tonë, ku Kosova ka shënuar përmirësim të dukshëm në indekset e ndryshme ndërkombëtare. “Ndërsa shikojmë drejt së ardhmes, rruga jonë mbetet e vendosur drejt një integriteti më të thellë evropian.

Bedri Hamza, kandidat i PDK-së për kryeministër të Kosovës

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka nominuar Bedri Hamzën kandidat të PDK-së për kryeministër të Kosovës. “Si një personalitet i dëshmuar, Bedriu është përgjigjja jonë ndaj thirrjeve të qytetarëve për jetë, mirëqenie dhe të ardhme më të mirë e më të sigurt!”, ka thënë Krasniqi të mërkurën në një konferencë të përbashkët për medie me Bedri Hamzën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 MARS - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka njoftuar se Bedri Hamza do të jetë kandidat i kësaj partie për kryeministër të Kosovës. Krasniqi në një konferencë për medie ka thënë se Hamza është njeriu i duhur për këtë pozitë dhe për kohën në të cilën po kalon Kosova, andaj edhe i ka kërkuar ta marrë këtë përgjegjësi. “Unë sot jam krenar dhe shumë i lumtur që ta prezantoj para jush Bedri Hamzën, kandidatin tonë për kryeministër të Republikës së Kosovës. Njeriu që do ta ringjallë ekonominë tonë, njeriu që do ta udhëheqë ekipin më të denjë për ta rikthyer Kosovën në rrugën e zhvillimit dhe integritetit. Bedriu është i dëshmuar, është i provuar, është i përkushtuar dhe i gatshëm. Bedri Hamza është njeriu i duhur për këtë detyrë. Arritjet e tij në të kaluarën si ministër i Financave, si guvernator i Bankës Qendrore të Kosovë, por edhe të arriturat e tanishme si kryetar i Mitrovicës, flasin më së miri për punën e tij. Në secilën detyrë publike, Bedriu ka shkëlqyer dhe ka lënë prapa rezultate të mëdha. Ai ka

dëshmuar se gjithmonë i ka shërbyer të mirës së përbashkët dhe është siguruar që askush të mos mbetet prapa”, ka thënë ai. Duke kërkuar që zgjedhjet e reja të mbahen sa më parë, sepse është dëshmuar se çdo ditë e qeverisë Kurti në pushtet është ditë e humbur për Kosovën, Krasniqi tha se modelit aktual të udhëheqjes nga një njeri, PDK-ja do t'i vë përballë modelin e udhëheqjes nga një ekip. “Ekonomia dhe mirëqenia e qytetarëve është dështimi më i madh i kësaj qeverie dhe gjendja po përkeqësohet dita-ditës. Megjithatë, të dashur bashkëqytetarë, sot nuk është koha për dëshpërim apo dorëzim. Është koha për veprim, për bashkim dhe për vendosmëri të palëkundur për ta mundur ringjalljen e Kosovës, rikthimin e besimit dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë. Në këtë fushë do të jetë edhe beteja për qeverinë e re. Për ta ndaluar rënien e mëtejme dhe për të sjellë prosperitet për të gjithë, pa dallim”, ka thënë Krasniqi. Krasniqi ka thënë se një detyrë e tillë artë kërkon qëndrueshmëri, përkushtim, transparencë, drejtësi, mbi të gjitha përvojë dhe kompetencë. “Kjo detyrë kërkon në ballë një shërbyes publik të



dëshmuar, me përvojë, dhe të përkushtuar për ta rikthyer Kosovën në binarët e zhvillimit. Një udhëheqës që kurrë nuk është lëkundur në besnikërinë dhe angazhimin e tij ndaj shtetit tonë. Një lider që u ofron qytetarëve parashikueshmëri dhe siguri. Dhe, Kosova e ka një personalitet të tillë”, ka thënë ai. Krasniqi ka thënë se ky vendim nuk nënkupton se ai si kryetar i partisë po e shmang një përgjegjësi, por sot Kosova është në udhëkryq mbi të gjitha për shkak të ekonomisë së rënduar e të stagnuar. “Gjithmonë e kam parë veten si një lider politik i cili

mundëson frymën e bashkëpunimit dhe suksesit, pa konsideruar ambicien personale si prioritet. Sepse, sot nuk është koha e ambicieve personale. Sot nuk është koha e protagonizmave lideristë. Sot është koha për të mbledhur në një vend të gjitha potencialet e vendit tonë, për t'i dhënë Kosovës një qeveri të re, kompetente, vizionare dhe që mendon për secilin qytetar. Një qeveri që udhëheq me modesti e pa arrogancë, me frymë ekipore dhe gjithëpërfshirëse. Kjo është mënyra se si unë e perceptoj shërbimin publik. Ne jemi këtu për të shërbyer, jo për të na

shërbyer. Dhe në këtë drejtim, do të bashkëpunojmë me të gjithë ata që dëshirojnë t'i japin Kosovës një drejtim të ri. Unë dhe PDK-ja jemi të përkushtuar për këtë qëllim. Kjo është arsyeja pse sot e shpall Bedri Hamzën kandidatin tonë për kryeministër të ardhshëm të Kosovës. Përtej PDK-së, Bedriu na bashkon të gjithëve. Dhe Bedriu do të punojë për të gjithë. Unë dhe të gjithë ne në PDK, e jam i bindur se edhe shumë qytetarë, përtej dallimeve politike, do të punojmë shumë për t'u siguruar se Bedri Hamza do të jetë kryeministri i ardhshëm i Kosovës”, ka thënë Krasniqi.

Diskutimet e sotme jo vetëm që do të reflektojnë mbi arritjet tona, por do ta përshkruajnë rrugën për sfidat dhe mundësitë që na presin. Angazhimi ynë për reforma, së bashku me mbështetjen e vazhdueshme nga Bashkimi Evropian, do të na shtyjë drejt vizionit tonë të përbashkët për një Evropë paqësore, të begatë dhe të integruar”, theksoi Kusari-Lila. Lukas Mandl, bashkëkryesues i Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë, në paraqitjen e tij bëri thirrje për zbatim të plotë të marrëveshjeve të Brukselit dhe Ohrit, ndërsa përkujtoi se Parlamenti Evropian ka kërkuar heqjen e masave ndaj Kosovës. Sipas tij, dialogu Kosovë - Serbi do të ketë kuptim vetëm kur të mbahet në frymën e mirëbesimit dhe të kompromisit për të arritur një marrëveshje

ligjërish të obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve. Ai tha se takimi i sotëm është vazhdimësi e takimeve që janë mbajtur më herët dhe se zhvillohet në një moment me rëndësi për Kosovën dhe BE-në. “Nga takimi i marsit Kosova ka përjetuar dy ngjarje, dhuna në maj dhe sulmi terrorist në Banjaskë. Përsëris thirrjen e PE-së për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Ftoj që të ketë implementim të plotë të marrëveshjeve të Brukselit dhe Ohrit, pa vonesa. Theksoj se Parlamentit Evropian i vjen keq për masat që i janë bërë Kosovës dhe kërkon heqjen e tyre”, theksoi Mandl. Duke marrë fjalën në takim, zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se Republika e Kosovës i vlerëson lart rezolutat dhe thirrjet e vazhdueshme të

Parlamentit Evropian për njohjen e Kosovës nga pesë shtetet mosnjohëse, për njohjen e përparimit që Kosova ka arritur në reformat e thella politike dhe ekonomike, që ndërlidhen me integrimin tonë evropian, për marrjen e vendimit për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë, për mirëpritjen e aplikimit tonë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, për mbështetjen e aplikimit tonë në Këshillin e Evropës, për thirrjen ndaj Komisionit Evropian për largimin e masave restriktive, si dhe për dënimin e sulmit agresor e terrorist në Banjaskë në termat më të ashpër. Ai tha se Kosova i përket Bashkimit Evropian dhe po punohet secilën ditë që kjo të bëhet realitet sa më shpejt, jo vetëm si qëndrim politik, por edhe si qëndrim e vullnet i qytetarëve të vendit.

Edhe ministri për Kthim dhe Komunitete në Qeverinë e Kosovës, Nenad Rashiq, bëri thirrje të hiqen masat ndaj Kosovës, duke i konsideruar tragjikomike. “Kemi dy programe të bashkëfinancuara dhe këto kanë për qëllim mbrojtjen e komuniteteve dhe forcimin dhe kam kërkuar nga z. Tomas dhe ju lus të bëni çmos t'i përjashtoni këto dy programe nga masat. Me këto masa po i godisni komunitetet, ju lus të bëni diçka për këto masa sepse nuk po mund të bëjmë diçka me programet”, theksoi Rashiq, duke shtuar se po bën çmos që serbët në katër komunat në veri të marrin pjesë në zgjedhje. Shefja e Sektorit Politik, Ekonomik për Integrim Evropian, Anna Carin Platon, duke folur në emër të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikës së Sigurisë dhe në

emër të Komisionit Evropian, rikonfirmoi bashkëpunimin në mes të BE-së dhe Kosovës, ndërsa shtoi se është e rëndësishme që Kosova t'i zbatojë reformat dhe të arrijë përparim, duke përmendur një varg objektivash që duhen realizuar. Takimi i komisionit ka vazhduar me diskutimet e nënkryetarit Bahrim Shabani, deputetëve Fitore Pacolli Dalipi, Armend Muja dhe Eliza Hoxha, si dhe europarlamentarëve Thijs Reuten dhe Ladislav Ilçiq. Gjatë fjalimeve ata paraqitën pikëpamjet e tyre lidhur me përparimin dhe sfidat në fushën e reformave të lidhura me integrimin në BE, dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë i lehtësuar nga BE-ja, si dhe bashkëpunimin rajonal dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.

Latifi takon përfaqësuesit e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, diskutojnë për donacionet ndërkombëtare

PRISHTINË, 27 MARS - I shoqëruar nga drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Berat Duraku, kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka

takuar Zana Beqirin, drejtoreshë ekzekutive në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës dhe anëtarin e bordit, Agon Makolli. Ata diskutuan për

mundësinë e bashkëpunimit për përfshirjen e komunës së Rahovecit për aplikim në fondet e BE-së, të UNDP-së dhe për donacione të

tjera ndërkombëtare, për bujqësi dhe biznese, me qëllim të mbështetjes së fermerëve dhe të bizneseve të komunës sonë.



Komuna e Mitrovicës pranon donacion 500 pako ushqimore

MITROVICË, 27 MARS - Komuna e Mitrovicës ka pranuar donacion nga Ambasada e Katarit në Tiranë, 500 pako ushqimore për familjet në nevojë.

Gjatë shpërndarjes së këtyre pakove, të pranishëm ishin drejtoresha e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, Drita Ibrahim, diplomatë nga Ambasada e Katarit, përfaqësues autoritativë të "Qatar Charity" dhe përfaqësues nga Presidenca. Drejtoresha e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, Drita Ibrahim, ka shprehur falënderimin për kontributin e Ambasadës së Katarit, duke theksuar rëndësinë e ndihmës së tyre për familjet në nevojë, veçanërisht gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit. Ky veprim i Ambasadës së Katarit thekson përkushtimin e tyre të vazhdueshëm për të kontribuar në mirëqenien dhe solidaritetin ndërkombëtar, ndërsa thekson rëndësinë e bashkëpunimit dhe ndarjes së vlerave njerëzore.



Totaj falënderon banorët e Prizrenit për qytetari aktive dhe bashkëpunim



PRIZREN, 27 MARS - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka kryesuar të mërkurën mbledhjen e radhës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), në sallën e Kuvendit të Komunës, në Shtëpinë e Bardhë. Me këtë rast, kryetari Totaj i ka falënderuar banorët e komunës së

Prizrenit për qytetari aktive dhe bashkëpunim me të gjitha institucionet e sigurisë në Prizren. Gjatë këtij takimi u bë vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Prizrenit, raporti nga Policia e Kosovës për vitin 2023 dhe plani operativ për vitin 2024, parkimi i veturave në

trotuare, me theks të veçantë te Hotel "Theranda", shqyrtimi i bashkërendimit të projekteve për sensibilizim dhe siguri nga Policia, Drejtoria e Komunale e Arsimit, drejtoritë e tjera si dhe KKSB-ja dhe rekomandimet dhe sugjerimet nga anëtarët e KKSB-së për organet gjegjëse për vitin 2024.

Bulliqli bashkëbisedoi me nxënës të shkollës "Shaban Shala" për orientimin në karrierë

PODUJEVË, 27 MARS - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqli, së bashku me kryetarin e Gjykatës Themelore - Dega në Podujevë, Minir Hoti dhe shefen e Operativës Policore në Podujevë, Antigona Çitaku-Dibrani, ishin pjesë e një paneli të diskutimit me nxënës të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Shaban Shala" për të diskutuar për orientimin në karrierë.

Gjatë këtij eventi nxënësit u shtrinin pyetje panelistëve, kurse ata përgjigjeshin në çdo pyetje apo çështje që kishin interesim nxënësit.

Bulliqli i inkurajoi nxënësit që ëndrrat që i kanë të punojnë



shumë e me vendosmëri për t'i realizuar, duke punuar me përkushtim dhe me dashuri. Pas diskutimit u dhanë mirënjohje për nxënësit që kanë arritur suksese në gara shkollë në lëndë të ndryshme.

10 familje me shtëpi të reja banimi në Malishevë

MALISHEVË, 27 MARS - Dhjetë familje në komunën e Malishevës janë bërë me shtëpi të reja. Kryetari i Malishevës, Ekrem Kastrati, ka bërë me dije se para një

viti kanë nisur një bashkëpunim shumë të mirë me organizatën "Qatar Charity", i cili bashkëpunim po rezulton me ndërtimin e shtëpive të reja për familjen

në nevojë. "Sot i kemi ndarë çelësat e shtëpive të ndërtuara dhe mobiluara tërësisht për 10 familje, që jetojnë në kushte të vështira ekonomike e

sociale. E uroj nga zemra secilën familje që nga sot do të jetojnë në kushte më të mira dhe me mirëqenie sado më të lartë", ka thënë kryetari Kastrati.



Hovenieri: Integrimi evropian dhe euroatlantik i Kosovës, urgjencë e qartë



PRISHTINË, 27 MARS - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të mërkurën se për Kosovën është e qartë urgjenca për integrim evropian dhe euroatlantik dhe se kjo nënkupton siguri, prosperitet dhe demokraci për popullin e saj. “Integrimi i saj është thelbësor edhe për ta arritur sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë në rajon”, tha Hovenier. Kosova aplikoi për anëtarësim në BE më 2022 dhe është vendi i vetëm nga Ballkani Perëndimor që ende nuk e ka fituar statusin e vendit kandidat.

Duke folur në një ngjarje në Prishtinë për shënimin e 25-

vjetorit të fillimit të sulmeve ajrore të Aleancës Veri-Atlantike (NATO) kundër caqeve ushtarake policore në ish-Jugosllavi, Hovenier tha se ShBA-ja e sheh stabilitetin dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor si një premtim të rëndësishëm që duhet të përmbushet, posaçërisht pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia e Vladimir Putin. “Njëzet e pesë vjet më parë, NATO-ja veproi për ta çuar përpara një vizion për një Evropë të lirë dhe paqësore. Edhe sot ne po punojmë për ta arritur këtë”, tha Hovenier duke folur në ngjarjen e organizuar nga Universiteti i Prishtinës dhe

Universiteti i Arkansasit. Më 24 mars 1999 NATO-ja i nisi sulmet ajrore kundër caqeve ushtarake policore në ish-Jugosllavi. Pas 78-ditësh të sulmeve, bombardimet u ndërpre në 10 qershor 1999, me miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë mundësoi kthimin në shtëpitë e tyre të më shumë se 800 000 persona të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës. Hovenieri e ritheksoi përkushtimin e Shteteve të Bashkuara që “ngjarjet e

tmerrshme që ndodhën në Kosovë 25 vjet më parë të mos përsëriten kurrë më”. Njëzet e pesë vjet pas kësaj ndërhyrjeje ushtarake, NATO-ja e ka në Kosovë misionin e vet paqeruajtës, KFOR, me praninë e një numri shumë më të vogël të ushtarëve, 4 700 sosh. “Ne jemi të përkushtuar për ta mbështetur rolin e vazhdueshëm stabilizues që forca e NATO-s e luan në Kosovë”, shtoi ai. Hovenieri ua bëri të qartë autoriteteve të Kosovës, megjithatë, se rruga e vetme për integrimin e Kosovës në institucionet evropiane dhe euroatlantike është përmes

dialogut me Serbinë nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. “Posaçërisht, përmes mirëbesimit dhe zbatimit të të gjitha marrëveshjeve që Kosova i ka arritur përmes dialogut”, tha ai. Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore në fillim të vitit 2023. Por, BE-ja, e cila e ndërmjetëson dialogun mes tyre nga viti 2011, ka thënë se marrëveshja nuk është duke u zbatuar, megjithëse është detyruese për palët. Marrëdhëniet mes ShBA-së dhe Qeverisë së Kosovës kanë arritur pikën më të ulët në fillim të këtij viti, kur autoritetet e Kosovës vendosën ta ndalojnë përdorimin e dinarit serb në Kosovë për pagesa me para të gatshme përmes një rregulloreje të Bankës Qendrore, e cila nga 1 shkurti e përcaktoi euron si valutën e vetme zyrtare në vend. ShBA-ja i ka bërë thirrje Kosovës ta pezullojë rregulloren për t’u dhënë kohë qytetarëve të prekur që të përshtaten me praktikën e re. I dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se me mospërmbushjen e kërkesës amerikane për çështjen e dinarit, Qeveria e Kosovës nuk po e trajton Uashingtonin si partner. Hovenieri tha të mërkurën se pret nga Qeveria e Kosovës - “sikurse kemi pritur nga qeveritë e mëparshme kosovare” - të punojë në partneritet “për t’i vazhduar përpjekjet tona për të ndërtuar një rajon të sigurt, shumetnik dhe stabil”.

Osmani: Asociacioni nuk është kusht për Këshillin e Evropës

PRISHTINË, 27 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, deklaroi të mërkurën se themelimi i një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe nuk është kusht për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Duke folur për gazetarë në Prishtinë, Osmani tha se raportuesja për Kosovën, Dora Bakoyannis, rekomandon se Kosova i ka përmbushur kushtet për t’u bërë anëtare e plotë e Këshillit të Evropës. “Në qoftë se e lexoni letërën e saj, në veçanti paragrafi i 11-të i raportit, e qartëson se kur flitet për Asociacionin, flitet si një prej detyrimeve pas anëtarësimit, pra nuk flitet për këtë fazë për themelim të Asociacionit”, tha Osmani. Osmani i bëri këto komente pasi i dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, në një intervistë dhënë REL-it më 15 mars, sugjeroi se Asociacioni dhe çështja e disa shpronësimeve në veri të



Kosovës mund të nxirren si kushte shtesë nga disa shtete evropiane. Komiteti për Politikë dhe Demokraci të Këshillit të Evropës do të mbajë një mbledhje, ku pritet të votohet raporti i Bakoyannis. Kosova aplikoi në majin e vitit 2022 për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Anëtarësimi i saj është riaktualizuar në javët e fundit

pasi, me kërkesën e Qeverisë së Kosovës drejtuar Agjencisë Kadastrale për transferimin e 24 hektarëve tokë në emër të Manastirit të Deçanit, është përmbushur një nga kushtet kryesore për anëtarësim. Nëse Kosova merr dritën jeshile në Asamblenë Parlamentare në prill, atëherë fjalën përfundimtare duhet ta japë Këshilli i Ministrave i Këshillit të Evropës në maj.

Osmani tha se Kosova e ka dhënë përkushtimin e saj për ta themeluar Asociacionin më 2013 dhe më 2023, “pra ky nuk është përkushtim i marsit 2024, është përkushtim i Marrëveshjes bazike të viti 2023”. Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Por, më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën. Serbia kërkon që Kosova t’i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik. Të hënën, Partia Demokratike Popullore (PDP) në pushtet në Mal të Zi tha se e mbështet deputeten e vet, Maja Vukiçević, si kryetare e delegacionit malazez në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), për të votuar

kundër pranimin të Kosovës në këtë organizatë. Osmani tha se institucionet e Kosovës janë angazhuar për të lobuar me vendet anëtare për anëtarësimin e vendit në këtë organizatë. “Janë disa hapa që kanë mbetur, por ajo që mund të them është se të gjitha nivelet e institucioneve janë angazhuar me deputetët e Asamblesë Parlamentare, por edhe jemi duke biseduar me shtet veç e veç, si presidente në veçanti jam e angazhuar me liderët e shteteve”, tha Osmani. Këshilli i Evropës është organizatë lidere në Evropë në fushën e të drejtave të njeriut. Pjesë e tij janë 46 shtete, përfshirë 27 vende anëtare të Bashkimit Evropian dhe të gjitha vendet e rajonit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut - me seli në Strasburg, Francë - bën monitorimin e zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Mbështetja për bizneset, MINT lanson thirrje publike në vlerë 2.5 milionë euro

PRISHTINË, 27 MARS - Në vlerë prej 2.5 milionë eurosh, janë lansuar të mërkurën tri thirrje publike për përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për blerjen e makinerive prodhuese dhe përpunuese nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) si pjesë e planit trevjeçar të politikës industriale. Ministria Rozeta Hajdari në një konferencë për medie, derisa ka shpalosur lansimin e këtyre tri thirrjeve, ka theksuar se e gjithë kjo mbështetje synon fuqizimin e ekonomisë dhe zhvillimin e ndërmarrësve që kanë shumë potencial. “Përkrahja dhe fuqizimi i bizneseve tona që janë shtytës kryesorë të zhvillimit dhe transformimit socio-ekonomik dhe mjedisor në vendin tonë, është një nga synimet kryesore të qeverisjes sonë. Masat që i kemi zhvilluar dhe instrumentet e ndryshme mbështetëse për ndërmarrjet fillestare, mikro, të vogla dhe të mesme, si në rastin konkret, sot janë tre grant-skema që po lansojmë, janë masa në

kuadër të planit trevjeçar të politikës industriale, respektivisht strategjisë ambicioze për zhvillimin e industrisë dhe përkrahjes së bizneseve me vizion të qartë që deri në vitin 2030 ndërmarrjet tona të jenë të integruara globalisht dhe kjo strategji është miratuar në qershor të vitit 2023”, ka thënë Hajdari. Derisa ka treguar vlerën e kësaj thirrje publike, ajo ka thënë se do të jetë e hapur deri më 19 prill për të gjithë ata që duan të aplikojnë. “Vlera e mbështetjes 2.5 milionë euro që po lansojmë në tri grant-skema, si grant-skema për blerjen e makinerive prodhuese dhe përpunuese, grant-skemën për certifikimin e produkteve dhe atë për digjitalizimin e bizneseve, të gjitha këto thirrje janë sot të lansuara nga platforma e agjencisë së shoqërisë së informacionit, ASH-i, që nga ora 13:30 dhe do të jenë të hapura deri më 19 prill 2024 dhe aplikimi bëhet përmes platformës e-Kosova. Ata që janë të familjarizuar me sistemin, mund



të fillojnë me aplikimin që sot”, ka thënë Hajdari. Ndërsa nga vlera prej 2.5 milionë eurosh, 1.7 do të jenë të dedikuara për grant-skema për blerjen e

makinerive prodhuese dhe përpunuese, 500 mijë euro për grant-skemën për certifikimin e produkteve, si dhe 300 mijë euro për digjitalizimin e bizneseve, ku

kjo e fundit është në bashkëpunim dhe financim me projektin nga mbështetja e Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

ATK-ja u bënë thirrje tatimpaguesve t'i raportojnë sponsorimet

PRISHTINË, 27 MARS - Administrata Tatimore e Kosovës njofton të gjithë tatimpaguesit, gjeëgjësisht personat juridikë, të cilët kanë dhënë dhe japin sponsorime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, se janë të obliguar të dorëzojnë në ATK vërtetimin nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe dëshmitë e pagesave në emër të sponsorimit. “Tatimpaguesi i cili jep sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit është i obliguar që të dëshmojë dhënien e sponsorizimit si kontribut për aktivitete me interes publik, përmes vërtetimit nga MKRS-ja dhe pagesës së sponsorizimeve, me qëllim që të përfitojë zbritjen nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave”, thuhet në njoftimin e lëshuar nga ATK-ja. Më tutje në njoftim thuhet se nëse



sponsoruesi ka statusin e personit juridik dhe dëshiron të japë kontribute, sponsorime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, atëherë ato kontribute duhet të llogariten sipas Ligjit për Sponsorizime në fushën e

Kulturës, Rinisë dhe Sportit. “Pra, sipas Ligjit nr. 05/L-090 për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazë për llogaritjen e përqindjes së sponsorizimeve në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë, është tatimi në

fitim dhe zbatohet me deklaratën vjetore ‘CD’ të periudhës përkatëse”, thuhet në njoftim. Po ashtu, ATK-ja njofton të gjithë tatimpaguesit që kanë dhënë dhe japin sponsorime, se obligohen të dorëzojnë në ATK vërtetimin nga

MKRS-ja si dhe dëshmitë e pagesave në emër të sponsorimit përmes adresës elektronike apo zyres përkatëse të Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve në ATK. “Administrata Tatimore e Kosovës u bënë thirrje të gjithë tatimpaguesve të cilët kanë shfrytëzuar zbritjen e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave për vlerën e sponsorizimeve të dhëna dhe nuk posedojnë dokumentacionin në rregull ashtu siç kërkohet me Ligjin për Sponsorizime, Rregulloren për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, që të bëjnë korrigjimet e tyre në deklaratat tatimore për periudhën përkatëse, në të kundërtën ATK detyrohet që të ndërmarrë masat e përcaktuara me Ligj”, thuhet në njoftimin e ATK-së.

Hoti: Ndërhyrjet e qeverisë në institucione të pavarura po e dëmtojnë ekonominë dhe investimet

Prishtinë, 27 mars - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë të mërkurën se ndërhyrjet e qeverisë në institucione të pavarura po e dëmtojnë ekonominë, po e përkeqësojnë ambientin për biznes dhe po dërgojnë sinjale shumë negative për investorët vendorë dhe të jashtëm. Hoti në “Facebook” ka shkruar se dy oda ekonomike në Kosovë kanë shprehur shqetësimet e tyre për ndërhyrjet e fundit të

Ministrit të Drejtësisë në institucionin e përmbartës, duke e suspenduar një përmbartës dhe, sipas tij, ky veprim paraqet një precedent të rrezikshëm. “Për shumë vjet qeveria e ShBA-së ka ndihmuar sistemin e drejtësisë në Kosovë për t'u reformuar në përputhje me praktikën më të mira perëndimore dhe për të qenë mbështetës për bizneset. Si rezultat i këtyre reformave është rritur efikasiteti në përmbartjen e lëndëve civile

të vendosura nga gjykatat. Këto ndërhyrje e hedhin poshtë gjithë atë mbështetje dhe ndikojnë negativisht në kushtet e të bërit biznes në Kosovë. Këto ndërhyrje krijojnë pasiguri tek bizneset”, ka shkruar Hoti. Sipas tij, ambienti për biznes përmirësohet duke ofruar siguri dhe qartësi ligjore. “Për biznesin është jetike që të ketë parashikueshmëri në veprime ekzekutive të qeverisë dhe në politika ekonomike e nisma ligjore”, ka shkruar deputeti i LDK-së.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (12)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-53-
GRS 1390
Kopje origjinale

Fm Beograd 121345z, korrik '81
Prioritet parësor FCO
Nr. tel. 86 datë, 10 qershor 1981
përsëritur prioritet për UKDEL
NATO, Washington, Moduk.
Telegrami im nr. 85
15 qershor 1981

Kosova: situata e sigurisë

1. Herljeviç, sekretari Federal për Punët e Brendshme, i paraqiti Kryesisë Federale më 9 qershor vlerësimin më të hollësishtëm deri më sot mbi situatën e sigurisë në Kosovë.

2. Herljeviç ia atribuoi aktivitetin kundërrevolucionar në Krahinë fushatës së vazhdueshme dhe të mirë organizuar nga nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë, të cilët kanë arritur të fitojnë dimensionet aktuale si rezultat i indoktrinimit të gjerë dhe të thellë, tolerancës së gjatë dhe mungesës së vigjencës politike ndaj saj. Përgjegjësia për këtë qëndrim tolerant ishte akoma më e madhe, pasi Tito në vitin 1975 dhe 1979 dhe Kardelj në vitin 1977 kishin dhënë paralajmërimë të qarta.

3. Në mars dhe prill, irredentistët dhe nacionalistët shqiptarë kanë organizuar 16 demonstrata dhe aksione të tjera në 11 komuna të Kosovës, në të cilat ata iu kthyen përdorimit të dhunës, duke përfshirë të shtënat dhe shkatërrimin e pronës shoqërore dhe vetjake, e duke rrezikuar kështu sigurinë e njerëzve. Ai përsëriti se 9 njerëz (8 demonstrues dhe 1 milic) humbën jetën e tyre dhe 257 të tjerë (133 anëtarë të forcave të sigurisë dhe 124 demonstrues) u plagosën. Ai theksoi se Sekretariati Federal i kishte propozuar Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Kosovës para demonstratave më 25/26 mars që të kërkonte ndihmë nga jashtë Krahinës. Autoritetet kosovare refuzuan dhe kërkuan ndihmë vetëm kur nuk qenë në gjendje të përballonin prishjen e qetësisë dhe rendit. Ai zbuloi më tej se që më 3 prill e deri më 26 maj nacionalistët ishin përpjekur rreth 10 herë për të organizuar demonstrata dhe ia dolën në tre qytete të vogla dhe tre herë në Prishtinë.

4. Forcat e sigurisë kishin zbuluar një numër organizatorësh të

drejtpërdrejtë të cilët i përkisnin një organizate të njohur irredentiste “Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve të Tjera Shqiptare në Jugosllavi”. Kjo organizatë mbështeste Partinë e Punës së Shqipërisë dhe u organizua në sistemin Troika. Ajo e zhvilloi veprimtarinë e saj përmes “komiteteve lokale” dhe kishte edhe një organizatë rinie. Deri më sot janë zbuluar 9 organizata ilegale të kësaj “lëvizjeje”. Gjithashtu, janë identifikuar 5 anëtarë të “Komitetit Qendror” të saj, 3 nga të cilët janë arrestuar dhe 2 janë jashtë vendit. Një numër i anëtarëve të organizatës “Lëvizja” ishin aktivë në radhët e punëtorëve shqiptarë jashtë vendit ku kishin formuar një organizatë të njohur si “Fronti i Kuq Popullor” i cili mbështeste Partinë e Punës së Shqipërisë dhe kishte lidhje me Kosovën dhe pjesë të tjera të Jugosllavisë. Kohët e fundit janë arrestuar 1,700 veta nga të cilët 506 janë dënua, si dhe ka filluar procedimi penal ndaj 154 të tjerëve. Ai shtoi se pjesa më e madhe e këtij grupimi të fundit ishin intelektualë.

5. Përveç “Lëvizjes” së përmendur më lart, ai deklaroi se në vitin 1979 deri 1981 ishte zbuluar një organizatë tjetër - Partia Komuniste Marksiste-Leniniste Shqiptare e Jugosllavisë. Kjo organizatë kishte të njëjtin objektiv si organizata “Lëvizja”, pra shkëputjen e të ashtuquajturave pjesë shqiptare të Jugosllavisë dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë e Madhe.

6. Duke iu kthyer përsëri organizatës “Lëvizja”, Herljeviç tha se deri tani ishin identifikuar 137 njerëz. Disa prej tyre ishin dënua më parë për aktivitet armiqësor dhe një numër i caktuar kishte pasur lidhje me shërbimin inteligjent shqiptar dhe emigrantët shqiptarë armiqësorë në Perëndim.

7. Anëtarët e këtyre grupeve ilegale ishin angazhuar në shtimin e anëtarëve të rinj në sistemin Troika, duke shkruar dhe shpërndarë broshura dhe fletushka. Me arrestimin e tyre, janë gjetur materiale propagandistike që flasin për indoktrinimin e të rinjve në mbështetje të Partisë së Punës së Shqipërisë. Ata po përgatiteshin për aktivitete armiqësore të dhunshme dhe masive.

8. Ai tha se këto grupe, kanë planifikuar të arrijnë objektivat e tyre kundërrevolucionare në tri faza: së pari, indoktrinimi i nacionalizmit/irredentizmit, duke krijuar pakënaqësi në mesin e shqiptarëve dhe duke e bërë organizatën kështu një lëvizje masive. Së dyti, kryerja e aktiviteteve propagandistike dhe demonstratave me qëllim që të tërhiqnin shqiptarët. Dhe së treti,

në rrethana të caktuara, organizimi i kryengritjes së armatosur dhe shkëputjes nga Jugosllavia. Kjo platformë ideopolitike nuk ndryshonte nga ajo e viteve të mëparshme, ku dallimi i vetëm në rrethanat aktuale ishte se njerëzit e përfshirë ishin më të arsimuar. Herljeviç përsëriti detajet e operacioneve të sigurisë kundër organizatave ilegale në Kosovë prej vitit 1974 deri në vitin 1981 (referuar në letrën e Clark 015/2 të datës 18 maj drejtuar Montgomerit).

9. Duke iu kthyer përgjegjësisë, Herljeviç tha se forcat e sigurisë në Kosovë ishin marrë kryesisht me individë nacionalistë dhe nuk kishin aktivë sa duhet në trajtimin e burimeve kryesore të frymëzimit, duke përfshirë atë nga Shqipëria. Për më tepër, disa individë që ishin përgjegjës për drejtimin e forcave të sigurisë dhe vetëmbrojtjes shoqërore nuk i dhanë rëndësinë e duhur politike dhe të sigurisë informacioneve për përgatitjen e aktiviteteve armiqësore në dispozicion të tyre. Autoritet e sigurisë në Serbi dhe Federatë nuk morën informacionin e duhur në kohë për situatën në Kosovë.

10. Herljeviç tha se situata mbetej shumë e vështirë pasi armiku nuk ishte zbuluar dhe neutralizuar ende. Ai nuk e përjashtoi mundësinë që armiku mund të përpiquej të rifillonte aktivitete të tjera duke përdorur metoda më të egra të tilla, si: terrori, dhuna dhe rrëmbimi. Kjo tregohet nga këmbëngulja e armikut për të kryer forma subversione dhe forma të tjera të rezistencës pasive duke filluar me shkrimin e parullave armiqësore e deri tek vënia e zjarrit në prona. Ai vuri në dukje mënyrën me të cilën sinkronizoheshin parullat dhe broshurat si në përmbajtjen dhe kohën e shfaqjes së tyre. Ai përmendi më tej se forcat e sigurisë ishin vënë nën zjarr dy herë më 13 dhe 15 maj dhe se në pjesë të tjera të Jugosllavisë kishin ndodhur aktivitete armiqësore duke përfshirë përpjekjet për një demonstratë në Lubjanë.

11. Herljeviç u shpreh se qarqet zyrtare shqiptare, shtypi, radio dhe televizioni mbështesnin irredentistët dhe i inkurajonin ata për aktivitete të reja armiqësore, duke përfshirë në këtë kategori bombën e hedhur në Ambasadën jugosllave në Tiranë. Ai pretendoi se ishte zbuluar një numër i caktuar agentësh i shërbimit të fshehtë shqiptar në radhët e organizatave ilegale dhe organizuesve të demonstratave në Kosovë. Emigrantët shqiptarë të “Frontit të Kuq Popullor” dhe ustashë jashtë vendit ishin përfshirë gjer më sot në 20 demonstrata. Në këtë drejtim, ai theksoi se autoritetet e disa vendeve perëndimore nuk kishin

ofruar mbrojtjen e duhur për qytetarët jugosllavë. “Fronti i Kuq Popullor” ishte mbështetur nga anëtarë të ndryshëm të grupeve fraksioniste marksiste-leniniste të Partive Komuniste në vende të ndryshme perëndimore të cilat njihej se kishin kontakte me Shqipërinë. Emigrantët fashistë shqiptarë kishin nisur sërish të hedhin bomba në zyrën e aviokompanisë jugosllave “JAT” dhe zyrën jugosllave të shoqatës së turizmit në Bruksel. Ai tha se ishte e nevojshme për të parandaluar këtë lloj aktiviteti jashtë vendit duke i kushtuar më shumë vëmendje punëtorëve jugosllavë me origjinë shqiptare të cilët ishin të ekspozuar ndaj indoktrinimit të zyrtarëve shqiptarë dhe përfaqësuesve të ndryshëm nacionalistë dhe irredentistë.

12. Herljeviç tha se ngjarjet më të fundit treguan se forcat e brendshme të sigurisë së Kosovës ishin të pakta në numër dhe nuk ishin të pajisura dhe të përgatitura sa duhet. Kryesia e Kosovës kishte vendosur kohët e fundit që të rriste numrin e milicëve me 1,000 veta dhe të përmirësonte pajisjet e tyre. Në të njëjtën kohë do të dyfishohej numri i anëtarëve të shërbimit të sigurisë. Sekretariati Federal, Serbia dhe Vojvodina do të ndihmonin me formimin dhe pajisjen e njësive speciale të milicisë në Kosovë. Duke pasur parasysh situatën aktuale, ishte e nevojshme që të mbeteshin në fuqi masat e sigurisë të përfshira në periudhën e demonstratave, duke përfshirë praninë e forcave të milicisë nga jashtë Kosovës.

13. Herljeviç konkludoi se besonte që forcat e sigurisë do të ishin në gjendje të zbulonin armikun dhe ta neutralizonin atë, por që problemi më i madh do të ishte eliminimi i pasojave të indoktrinimit nacionalist. Ky ishte një problem afatgjatë. Bolland (Ky telegram nuk është përcjellë)

-54-
Për përdorim të kufizuar

Zagreb
17 qershor 1981
Inderuar Terry,

Situata e brendshme politike në Kosovë

1. Qëndrova sot një orë me Jaksha Petriç, anëtar i Kryesisë së Kroacisë, një nga kontaktet më të dobishme këtu, i cili është i gatshëm që të flasë hapur për çështjet kombëtare dhe lokale. Diskutuam së bashku për skenën politike kombëtare, Kosovën dhe Kroacinë.

2. Vetë Petriç, tha se problemi kryesor i vendit ishte ai i menaxhimit ekonomik dhe në veçanti arritja e kohezionit shumë të dëshiruar dhe marrëveshjes ndërmjet republikave (që Petriç e

krahasonte me shtetet sovraane në konfederatë) me tendencën e tyre të fortë për autarki. Petriç tërhoqi vëmendjen në takimin e përbashkët të kohëve të fundit midis kryesive të Federatës dhe të Partisë, të cilat ai i kishte ndjekur si përfaqësues i Bakariç, dhe Kryesisë Federative dhe Këshillit Ekzekutiv Federal, që i kishin kushtuar vëmendje serioze këtij problemi. Petriç tha se ishte rëndë dakord që masat të merreshin me marrëveshje para pushimeve verore për të ndaluar kalbjen, gjë që të gjithë e pranonin se kishte arritur shumë larg. Petriç shtoi se politika ishte që të përmirësohej dhe përshejtohej arritja e marrëveshjes për masat ekonomike në mes të republikave dhe krahinave. Nuk pati asnjë sugjerim për t'ia hequr kompetencat këtyre të fundit, gjë që nuk ishte nismëtare. Fjalimi i Djuranoviç në Kuvendin Federal, më 10 qershor, pasqyroi shqetësimin e përbashkët në nivel të lartë. Petriç e përshkruante Djuranoviç si një njeri të shqetësuar dhe përmendi për shembull, që niveli i investimeve ende nuk po binte. Petriç tha se nuk kishte mosmarrëveshje në nivel të lartë, ku kishte unitet. Problemi i vërtetë filloi kur njëra nga palët filloi të ulej në pozitë nga ata që ishin të bashkuar në krye; dhe sa më tej që largohej nga maja aq më e vështirë bëhej situata.

3. Në Kosovë, Petriç tha se autoritetet tashmë kishin arritur në fund të asaj që kishte ndodhur. Pjesa tjetër e Jugosllavisë ishte e vetëkënaqur, dhe jashtëzakonisht “liberale” (term të cilin mendoj se Petriç e përdorte në sensin jugosllav të “mosndërrhyjes”). Ka pasur neglizhencë në radhët e udhëheqjes së Kosovës, por vetëm pak prej tyre e dinin se çfarë po ndodhte dhe qëllimisht keqinformuan të tjerët, duke përfshirë në një fazë të mëvonshme, Dolane dhe Herljeviç, të cilët sidoqoftë kishin qenë të pafuqishëm në mos ishin nxitur nga autoritetet e Kosovës. Jugosllavët nuk u ngutën ndaj çështjes së Kosovës. Situata në bazë gradualisht po përmirësohej. Forcat speciale të SUP-it ishin tërhequr (sipas meje kjo nënkuptonte (?) njësi speciale dhe jo anëtarë të tjerë shtesë për të cilët Herljeviç tha se do të dërgohen). Shtytja kryesore e policisë do të jetë integrimi i ekonomisë me pjesën tjetër të vendit përmes investimeve ndërmjet republikave dhe krahinave në vend të sigurimit të komunikatave për burokracinë e Kosovës, që ka shkaktuar nacionalizmin dhe gjithfarë dokrrash. Petriç përmendi shembullin ku Kosova kishte përdorur fondet e ndihmave për të importuar pajisje të shtrenjta franceze në vend që të merrte një produkt po aq të mirë nga Kroacia.

Por, pjesa tjetër e vendit, duke përfshirë serbët, e pranonte që politikat duhet të ndiqeshin duke punuar me kosovarët dhe përmes tyre, dhe që këto politika do të duhej të ishin shumë afatgjata. Megjithatë, nuk mund të kishte asnjë ndryshim në statusin kushtetues të Kosovës. Përveç në forcën e ndjenjës serbe, ndryshimi kushtetues do të kishte implikime të rrezikshme tjetërkund në vend (Më vonë, Petriç tha nga njëra anë se mbetej çështje e hapur për të parë se çfarë mund të ndodhte, le të themi, në 20 vitet e ardhshme duke pasur parasysh se kosovarët ishin një popull që vinte duke u shtuar, por për momentin nuk do të kishte asnjë ndryshim).

4. Petriç tha më tej se durimi dhe kujdesi i jugosllavëve në trajtimin e Kosovës u pasqyrua në qëndrimin e tyre ndaj ambasadorit shqiptar në Beograd. Ai ishte përfshirë thellë në rrjetin “trojka” të ngritur nga shqiptarët, i cili tashmë ishte prishur (Petriç tha se ata kishin marrë Komitetin Qendror). Sipas standardeve normale, ambasadorit duhej t’i kërkohej që të largohej, por jugosllavët nuk dëshironin të lejonin ndonjë hapësirë, p.sh. përmes përshkallëzimit, për përfshirjen e ndonjë fuqie të madhe (duke nënkuptuar qartazi këtu atë sovjetike). Deri më tani nuk kishte pasur shumë tregues të një përfshirjeje të tillë megjithëse shiheshin përreth disa “peshkime klandestine duke çukitur grepin në skaje”; për shembull, shërbimi i fshehtë bullgar ishte në kontakt me shqiptarët për Kosovën. Shqiptarët ishin përgatitur në të kaluarën që të kërkonin mbështetjen sovjetike e më vonë atë kineze për çështjen e Kosovës, dhe jugosllavët nuk donin t’u jepnin atyre ndonjë pretext për këtë tani (rastësisht, Petriç më tregoi një histori të vogël se si, kur ai ishte futur në Partinë shqiptare, Enver Hoxha i kishte zënë be që do të punonte për marrjen e Kosovës).

5. Kroacia ishte e gatshme të investonte në Kosovë, për përfitim reciprok. Kroacia kishte mungesa të energjisë elektrike dhe ishte e gatshme, për shembull, të investonte në prodhimin e energjisë në Trepçë. Në përgjithësi, kroatët kanë qenë më të ashpër ndaj trazirave nacionaliste në Kosovë, dhe udhëheqësve kroatë u është dashur të frenojnë tundimin e tyre për të reaguar ndaj kosovarëve që jetonin aty. Vetë Petriç i kishte folur turmës në Brac, ishullin e tij të lindjes, e cila kishte dashur të dëbonte, dhe të vepronte akoma më keq, ndaj dyqanxhinjve kosovarë (shumica e ëmbëltoreve këtu dhe në Sloveni mbaheshin nga kosovarët). Gjithashtu, atij i është dashur të fliste me të birin në ushtri i cili, së bashku me shokët e tij, kishte dalë vullnetarë për të shkuar dhe “për t’i sjellë në vije” kosovarët. Ndjenja e përgjithshme, siç tha Petriç, ishte zemërimi se kosovarët kanë kërcënuar stabilitetin e vendit.

6. Lidhur me politikën e informimit, Petriç ishte kritik ndaj

keqinformimit dhe fshehjes që kishte ndodhur më parë, por ai ishte i kujdesshëm për sa i përket qarkullimit më të lirë të informacionit. Sipas tij, jo çdo informacion mund të vihej në dispozicion.

7. E pyeta Petriç për atmosferën politike në Kroaci, siç pasqyrohej në fjalimin e Baltiç drejtuar Komitetit Qendror kroat më 20 maj (përmendur në letrën time të datës 26 maj), ku sipas Baltiç kishte armiq pas çdo peme. Petriç komentoi se popullin mund ta kënaqje shumë lehtë dhe ishte e drejtë t’ia kujtoje kundërshtarë të ndryshëm, por ai mendonte se Baltiçi i kishte rënë tepër fyellit në këtë pikë dhe tabloja e shfaqur ishte mjaft e ekzagjeruar. Duke iu referuar kishës, Petriç foli me terma miqësore për refuzimin e Kuhariç dhe tarafit të tij për të pranuar shoqërinë aktuale jugosllave, duke kërkuar në Poloni - por ku historia dhe roli i kishës ka

raportimi midis nesh për Kosovën, për vlerësimin e ekonomisë së saj, por për arsye të ndryshme nuk kemi pasur burime për t’ia kushtuar një studimi të tillë. Disa të tjerë kanë pasur të njëjtën ide dhe në një nga takimet së fundmi të Këshilltarëve Tregtarë të Misioneve të Komunitetit Evropian këtu është vendosur që të ngrihet një grup i vogël pune për të shqyrtuar ekonominë e Kosovës. Sapo kam marrë një draft, i cili është shkruar kryesisht nga Këshilltari Ekonomik në Zyrën e KE-së këtu, e që pas miratimit nga të gjitha Misionet e KE-së, do të dërgohet në Hagë për Grupin e Punës të KEP-it të Evropës Lindore, i cili do të mblidhet më 22 qershor, me sa duket për të diskutuar për Jugosllavinë.

2. Këtë mëngjes nuk kam pasur kohë të shqyrtoj draftin, por vetëm i kam hedhur një sytë përciptë dhe mendova që duhet t’jua dërgoj juve pasi është pjesë e përgatitjes



qenë dhe është tërësisht ndryshe - një rol politik, që do t’u refuzohej atyre. Petriç ishte i vendosur kur deklaroi se nëse kisha e shkelte ligjin, atëherë do të merreshin me të. Ai shtoi se kisha ende po vazhdonte në këtë mënyrë dhe përmendi kontaktin e vazhdueshëm ndërmjet Kuhariç dhe grupimit më të keq të emigrantëve kroatë, duke përfshirë, tha ai, ish-famullitarin ushtarak të Pavlic, Cecelja, që aktualisht jetonte në Vjenë dhe ishte vetë në kontakt me emigrantët terroristë. Petriç nuk ishte plotësisht i kënaqur me qëndrimin e Vatikanit. Nga njëra anë Vatikani kishte marrëveshje me Jugosllavinë, të cilën e mirëpriti dhe u shpreh se do ta pranonte dhe respektonte, por nga ana tjetër, njerëzit në Vatikan vepruan ndryshe.

I Juaji
(P.E. Rosling)

-55-
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Ambasada britanike
Beograd
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
17 qershor 1981
I nderuar Alan,

Kosova: ekonomia
1. Prej njëfarë kohe na ka munguar

-56-
Konfidenciale
A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
17 qershor 1981
I nderuar Alan,

Kosova: situata e brendshme politike

1. Po përgatitesha t’ju shkruaja mbi zhvillimet e fundit për frontin e gjerë të përgjegjesisë për ngjarjet në Kosovë kur mbërriti letra juaj e datës 15 qershor, e cila më nxiti akoma më shumë. Siç e thoni edhe ju, Kosova ka hapur një fushë të rëndësishme të politikës për debatin publik dhe, siç më kanë thënë gazetarë të ndryshëm jugosllavë, shtypit i është dhënë

dorë e lirë jo vetëm për të raportuar ngjarjet, por edhe për t’i komentuar ato në mënyrë kritike. Është e qartë se njeriu nuk dëshiron ta çojë analogjinë shumë larg, sepse, siç u tha edhe në gazetën “Politika” një javë më parë, Jugosllavia do t’ia dilte mbanë më mirë pa traumën e Kosovës sa herë që do t’i nevojitej një impuls për të trajtuar një problem veçanërisht të vështirë.

2. Megjithëse data 15 qershor ishte e jashtëzakonshme në faktin që për herë të parë pas disa javësh gazeta “Politika” nuk kishte ngjarje për Kosovën, ende nuk ka reshtje në procesin e kritikës, vetëkritikës dhe “diferencimit”, siç quhet spastrimi (në dëshminë e fundit publike mbi 400 njerëz janë dëbuar nga LKJ-ja). Sidoqoftë, data 15 qershor nuk ishte një ditë e zbrazët për publikun e Beogradit pasi të gjithë ne u ngopëm me një film dokumentar 100-minutësh në TV për ngjarjet; kjo ishte përpejka e parë në trajtimin e kësaj teme në televizion dhe shembulli i parë që mund të mbaj mend nga gazetaria investigative në TV e stilit perëndimor, megjithëse në një mënyrë mjaft amatoreske. Pjesa më e madhe e iniciativës për debatin duket se vjen nga Serbia; gjithashtu po vërehet gjithnjë e më shumë një tendencë drejt ripohimit nga ana

e serbëve të pozitës së tyre përballë shqiptarëve në Kosovë. Siç e kam raportuar, shtypi i Beogradit është bërë gjithnjë e më shumë këmbëngulës për t’i kërkuar llogari personave përgjegjës për rritjen e nacionalizmit shqiptar. Korrespondentët e këtij shtypi kanë arritur që në shkallë të pashembullt të pasqyrojnë ngjarjet dhe të theksojnë në veçanti ato histori që duket se janë krijuar për të prekur pasionin e serbëve, p.sh. historitë për migrimin e detyruar të serbëve nga Kosova, gjë për të cilën është duke shkruar Charles Crawford. Shtypi aktualisht e merr sinjalin nga politikanët serbë, siç edhe konfirmohet nga disa shembuj që kanë ndodhur javën e fundit.

3. Herljeviç, sekretari federal i Punëve të Brendshme, i distancoi autoritetet federale të sigurisë nga përgjegjësia për shpërthimin e trazirave në Kosovë në një fjalim para Kryesisë Federative, më 9 qershor (përmendur në telegramin tonë nr. 86 të datës 10 qershor). Stanojeviç, sekretari serb i Punëve të Brendshme, mbajti qëndrim të ngjashëm në një debat për Kosovën në Kryesinë serbe, më 10 qershor. Ai pretendoi se megjithëse autoritetet serbe të sigurisë i kanë informuar rregullisht autoritetet kosovare për çdo gjë që kishin në lidhje me Kosovën, nuk ka pasur reciprocitet, veçanërisht lidhur me ngjarjet më të fundit. Ai përmendi në mënyrë specifike se autoritetet e tij ishin informuar vetëm më 1 maj të këtij viti për një sërë manifestimesh antiserbe dhe antijugosllave në Kosovë në vitin 1980; dhe kishin dëgjuar vetëm në fund të marsit të këtij viti për shpërndarjen e broshurave të “Partisë Komuniste Shqiptare Marksiste-Leniniste” të Jugosllavisë”, në periudhën midis marsit 1979 dhe nëntorit 1980. Ai vijoi më tej duke thënë se “njerëzit që janë më shumë përgjegjës në Sekretariatin Krahinor të Punëve të Brendshme, nuk arritën në thelb të pranonin vlerësimet dhe marrëveshjet e arritura në mbledhjen e datës 19 mars pas rrëmujave të para në Krahinë, pra ata nuk i respektuan vlerësimet pikërisht në mënyrën që kërkonte situata”. Ai shtoi se nëse nuk do të kishte pasur hezitim për faktin nëse kjo situatë quhej apo jo kundërrëvolucion, forcat serbe të sigurisë tashmë të mobilizuara do të dërgoheshin këtu për të penguar ngjarjet e 26 marsit dhe 1-3 prillit. Këto forca me sa duket ishin mobilizuar më 11 dhe 26 mars dhe 1 prill dhe ishin vënë në dispozicion të autoriteteve kosovare, por pas dy a tre ditësh u tërhoqën në secilin rast meqenëse autoritetet lokale u shprehën se këto forca nuk ishin të nevojshme. Si shembull tjetër i ftohtësisë së Kosovës, ai kujtoi se në vitin 1979 autoritetet e Kosovës kishin refuzuar të futeshin në një ushtrim për të testuar efikasitetin e forcave të sigurisë, përveç se në mënyrë shumë të kufizuar dhe vetëm kur pothuaj kishte

mbaruar. Si rezultat i ngjarjeve, ai pohoi se nacionalizmi i Serbisë së Madhe kishte filluar të ngrinte kokën, duke pretenduar që për këtë duhej të fajësohej i tërë nacionalizmi shqiptar. Ai tregoi 13 raste të shënuara me parulla shqiptare të shkruara, ku me përjashtim të njërit, ishin kapur autorët e të gjitha rasteve. Megjithatë, një delegat në debatin pasues protestoi se numri i pjesëmarrësve joshqiptarë që ishin arrestuar dhe dënuar, ishte i tepruar dhe i pavend dhe pretendoi se kjo ndodhte për shkak të përpjekjeve për të balancuar dënimin e shqiptarëve me atë të joshqiptarëve!

4. Në një seancë të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, më 15 qershor, u deklarua më tej se në disa komuna (të papërcaktuara) kishte pasur akte të ndryshme hakmarrjeje kundër shqiptarëve, të tilla si thyerja e xhamave të dyqaneve dhe shkarravitja e parullave. Dhe faji i mbeti nacionalizmit serb. Shtypi i Beogradit ka raportuar gjithashtu rënie të fortë në shitjen e ëmbëlsirave dhe akulloreve në dyqanet e zotëruara kryesisht nga shqiptarët, me sa duket pjesë e bojkotit të qëllimshëm nga ana e serbëve.

5. Pakënaqësia me progresin e ngadaltë të spastrimeve (të shqiptarëve) u shpreh nga një serb i Kosovës në Beograd, më 10 qershor, në mbledhjen e komunistëve kosovarë që punojnë në Administratën Federale këtu. Ai tha se Lidhja e Komunistëve të Kosovës nuk ishte e tëra fajtore, por vetëm ata që ishin në pozicione drejtuese. Deri në momentin që dikush të përmendte emra konkretë, ishte e vështirë të pritej një spastrim real. Ai vuri në dukje se zëvendësekretari i Punëve të Brendshme kishte dhënë dorëheqjen, por ai natyrisht nuk e shikonte këtë si zgjidhje të çështjes, sepse zëvendësekretari, tha ai, nuk mund të ketë marrë vendimin për të refuzuar ofertën e ndihmës Federale pa marrë paraprakisht pikëpamjet e Këshillit Ekzekutiv të Kosovës. Kryesia e Kosovës kishte ruajtur qetësinë dhe ky qëndrim inkurajoi edhe të tjerët të ruanin qetësinë. Ai besonte se sekretari krahinor i Punëve të Brendshme dhe të gjithë ata që e inkurajuan atë, duhet të shkarkohen dhe dënohen pas pranimit publik të fajit. Një serb tjetër u ankua se programi i veprimit të Komitetit Krahinor të LKK-së nuk shprehej mjaftueshëm për përgjegjësinë e udhëheqjes politike të Krahinës dhe se ishte e nevojshme që spastrimi të bëhej në nivel të lartë. Një shqiptar i Kosovës vuri në dukje disi në mbrojtje që të paktën për sa i përket politikës ndaj Shqipërisë, Kosova nuk ka vepruar pa dijeninë e organeve republikane dhe federative. Një shqiptar tjetër i Kosovës e mbylli mbledhjen me vërejtjen se edhe në këtë rast ka pasur mungesë të vetëkritikës dhe shmangie të

thirrjeve të individëve për të pranuar gabimet.

6. Filmi në TV i përmendur më lart tregonte shumë qartë problemet e përfshira në thirrjen e njerëzve për të dëshmuar. Rrëfyesi përpiquej të intervistonte një numër studentësh dhe nxënës shkollash në Prishtinë dhe gjetkë për dijeninë e tyre mbi ngjarjet dhe përfshirjen e tyre në to. Pothuaj në çdo rast, ai merrte përgjigje të tilla si: ata nuk dinin asgjë, atyre u është thënë të mos thonë asgjë, gjithsesi ata nuk janë përfshirë dhe nuk kanë folur serbo-kroatisht. Investigimi i kryer në një apo dy raste të viktimizimit të serbëve/malazezëve tregoi se policia lokale nuk kishte bërë asgjë për të ardhur në ndihmë në atë periudhë apo më pas. Rrëfyesi tregoi gjithashtu shifrën më të lartë deri më sot për numrin e pjesëmarrësve të përfshirë në demonstratat e prillit në Prishtinë - 10,000. Kështu, duke pasur parasysh numrat e dhënë dhe



hezitimim e njerëzve për të folur, nuk është fare për t'u çuditur që diferencimi po ecën ngadalë.

7. Gazeta “Politika” e 17 qershorit nxori në pah arsye të tjera të progresit të ngadaltë, duke raportuar se aktualisht po mbaheshin zgjedhjet në konferencat komunale të LKK-së dhe se kishte përplasje jo dinjitoze për heqjen e titullarëve aktualë nga pozicionet drejtuese! Gazeta “Politika” shtoi se asnjë nga kryetarët apo sekretarët e Lidhjes së Komunistëve në Komuna nuk e kishin parë të nevojshme deri më sot të kritikonin performancën e vet apo të jepnin dorëheqjen për shkak të demonstratave. Gazeta raportoi gjithashtu një qëndrim të ngjashëm midis kuvendeve të komunave, ku kryetarët dhe anëtarët e qeverive lokale vepronin “të qetë” sikur ngjarjet e fundit nuk kishin të bënin fare me ta, por ishin çështje ekskluzivisht të LK-së.

8. Një shembull i fundit se sa thellë ka rënë shtypi serb për të fajësuar shqiptarët doli në gazetën “Politika” më 12 qershor. Në një raport tejet të gjatë dhe të përfshirë në arkeologjinë e Kosovës, gazetari iu vu punës për të përcaktuar se autoritetet arkeologjike shqiptare lokale i kishin hyrë me qëllim punës për

të fshehur zbulimet arkeologjike që tregonin kolonizimet e hershme sllave të Kosovës dhe që do të tronditnin konceptin e një krahine shqiptare, të pastër nga pikëpamja racore!

9. Një numër i vogël i shqiptarëve të Kosovës, kryesisht nga Universiteti i Prishtinës, kanë akuzuar shtypin e Beogradit për raportim tendencioz, por është e vështirë për shqiptarët lokalë që të mbrojnë veten e tyre pa dalë para akuzave të nacionalizmit. Kështu, për momentin, serbët shijojnë argëtimin. Politikanët serbë vazhdojnë të vënë theksin në nevojën për të zbatuar Kushtetutën serbe në vazhdimësi dhe shqiptarët e Kosovës nuk kanë alternativë tjetër përveçse të shoqërohen me lëvizje të ndryshme për t'i vënë fre pavarësisë së tyre të veprimit. Por, politikanët serbë dhe federalë janë të vetëdijshëm për rreziqet nëse reagimet e ashpra të serbëve shkojnë shumë larg por jam i

sigurt se ata nuk do të lejojnë që situata t’u shpëtojë nga duart. Për momentin, kjo i shërben qëllimit të dobishëm për t’i thënë vazhdimisht shqiptarëve ngurrues të Kosovës që të shprehin me forcë mendimet e tyre.

I Juaji,
T. J. Clark
Për dijeni: P. E. Rosling Esq
Zagreb
P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit

-57-
Konfidenciale

ENU 015/3
19 qershor 1981
Ch d'A

Kosova: pozita kushtetuese

1. Në darkën me z. dhe znj. Raudenbush të Ambasadës së SHBA-së, më 12 qershor, takova një jurist kushtetues nga Universiteti i Beogradit, dr. Vladimir Kilibarda, i cili kryen specializimin për kushtetutat e shteteve federative. Dr. Kilibarda ka studiuar në Shtetet e Bashkuara (prandaj flet shkëlqyeshëm anglisht) dhe mendoj se ka marrë gradën doktor në Universitetin Stanford. Ai është

mik i ngushtë (megjithëse së paku dhjetë vjet më i ri) dhe bashkëlojtar në tenis me dr. Djurisiç. Ka lindur në Pejë.

2. Dr. Kilibarda foli në mënyrë interesante dhe shumë hapur për pozitën kushtetuese të Kosovës të cilën ai e përshkruan si “të pabazë”. Ai më tha se tre a katër vite më parë ai dhe disa kolegë, të cilët gjithashtu ishin juristë kushtetues, kishin paraqitur një studim për pozitën e Kosovës, ku theksonte rreziqet që dalin përpara nëse Kushtetutat e Serbisë dhe Kosovës nuk përshtateshin për të marrë parasysh anomalitë e ndryshme të dukshme dhe për t’i bërë ato më të pajtueshme me njëra-tjetrën. Studimi u hodh poshtë nga autoritetet Federale dhe grupit të juristëve iu tha të mbyllnin gojën dhe të shikonin punën e tyre (ndaj pozitës së federatave përveç Jugosllavisë).

3. Sipas mendimit të dr. Kilibarda, pozita aktuale në Kosovë është e pashpresë. Situata kishte shkuar

deri në atë pikë sa ishte e pamundur për të futur ndryshime të nevojshme kushtetuese; sidoqoftë, autoritetet federale i kishin përjashtuar ato. Trazira aktuale vetëm mund të përmbahej, por jo të zhdukej, dhe kjo do të bëhej një faktor gjithnjë e më dobësues në jetën e Federatës Jugosllave.

4. Dr. Kilibarda tha se formula “Kosova Republikë”, pavarësisht se sa e papëlqyeshme për serbët, ishte e vetmja formulë logjike sipas së drejtës ndërkombëtare. Fjalimet e Titos dhe referencat e paqarta të “plebishiteve” dhe Aktit Final të Helsinkit, nuk ishin të mira sa duhet. Por, Jugosllavisë i duhej të jetonte me kontradiktat e Kosovës, meqenëse përfundimisht integriteti i Federatës ishte në rrezik dhe kjo pa dyshim, siç e kemi pranuar ne dhe shumë shtete perëndimore, kishte rëndësi të dorës së parë për Jugosllavinë dhe për pjesën tjetër të Evropës.

5. Dr. Kilibarda ishte i prerë në pohimin e tij se pas parullës “Kosova Republikë” nuk ishin makinacionet e Tiranës, Moskës apo ndonjë kryeqyteti tjetër të huaj, por ato të vetë shqiptarëve të Kosovës. Ky ishte rasti i irredentizmit në termat e Prishtinës dhe jo të Tiranës. Kosovarët dëshironin Republikën e tyre si

prelud për të realizuar ëndrrën e tyre të “Shqipërisë së Madhe”. Kjo nënkuptonte imponimin e nocioneve të tyre të kombësisë shqiptare dhe një rendi shoqëror për vetë Shqipërinë të cilin do të dëshironin ta transformonin në aspektin social, ekonomik dhe politik pas largimit të Hoxhës. Nëse agjitimi në Kosovë ia dilte të përshpejtonte këtë, aq më mirë nga pikëpamja e kosovarëve. Dr. Kilibarda theksoi se shumë pak prej parullave, nëse ekzistonin, ishin në të vërtetë “pro Hoxha” - ato ishin thjesht proshqiptare. Por natyrisht, autoritetet federale e kishin paraqitur situatën në një dritë tërësisht të ndryshme, d.m.th., që demonstruesit me sa duket dëshironin të bashkoheshin me Shqipërinë siç është tani, ose të impononin stanilizmin mbi veten e tyre (gjë që zor të jetë e besueshme).

6. Kur thashë se ajo që ai më kishte treguar mund të ishte të paktën pjesërisht përfundim i një studimi nga afër i shtypit jugosllav (pas mungesës fillestare të informacionit për atë që kishte ndodhur në Kosovë për kaq shumë vite), dr. Kilibarda ra dakord menjëherë. Ai tha se tashmë shtypi po luante një rol shumë pozitiv në informimin e njerëzve mbi rreziqet e situatës, që zor se mund të ekzagjerohej. Kjo nuk i pëlqente të gjithëve qoftë në Beograd apo Prishtinë. Në të vërtetë situata tregoi se si shtypi po shfaqej si “forcë politike” në Jugosllavi dhe ishte gjithnjë e më e vështirë, që pas ikjes së Titos, për t’i mbyllur gojën. Shumica e artikujve me emër në ditët tona e shohin rolin e tyre investigativ më shumë si parësor sesa dytësor në informimin e publikut jugosllav në lidhje me atë që po ndodhte.

7. Si federalist, dr. Kilibarda ishte qartazi në favor të fuqizimit të makinerisë federative dhe kundër delegimit të mëtejshëm të pushtetit politik në kryeqytetet e Republikave. Në këtë pikë, Kosova kishte nxjerrë një mësim të vlefshëm. Nëse pushteti politik do të ishte më shumë i përqendruar në Beograd, ngjarjet në Kosovë mund të ishin zbuluar shumë më herët dhe situata aktuale ndoshta mund të ishte evituar. Ai pranoi se pikëpamja e tij ishte jashtë mode (vetë ai nuk do ta kishte pranuar atë pak vite më parë), por të paktën një rikthim i kufizuar në centralizëm do të ishte i nevojshëm për stabilitetin e Jugosllavisë si në sensin politik dhe atë ekonomik. Ai tha se Djuranoviç të cilin e admironte, duhet të kishte si kryeministër i Federatës, shumë më tepër kompetenca dhe jo vetëm të natyrës ekzekutive.

8. Mbase mund të dëshironi të flisni me dr. Kilibarda ndonjëherë. Ai banon në adresën Ivana Milutinovića 88 (numri i telefonit 436-224). Mund të organizojmë një takim dreke ose darke të tre së bashku.

. I. Miller
15 qershor 1981
Për dijeni: J C R Gray Esq, EESD, FCO



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Zhegrova dhe Vojvoda: Gabimet na kushtuan me humbje

Dy futbollistët Edon Zhegrova dhe Mërgim Vojvoda kanë thënë se humbja në miqësoren nga Hungaria ka ardhur për shkak të gabimeve të cilat i bënë futbollistët “dardanë”. Ata kanë shprehur kënaqësi për paraqitjen në 60 minuta dhe kanë shprehur optimizëm se në ndeshjet e ardhshme nuk do të mungojnë paraqitjet dhe rezultatet pozitive

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 MARS - Kosova pësoi humbje të martën në mbrëmje nga Hungaria (2-0) në miqësoren që u zhvillua në Budapest. Një prej lojtarëve më të mirë për “dardanët” në këtë ndeshje ishte Edon Zhegrova, i cili ka thënë se humbja erdhi pas gabimeve të veta. “Mendoj se e kemi filluar ndeshjen shumë mirë, por besoj se pjesën e dytë pësuam pas gabimeve tona, kështu që këtu ka qenë lojë kontrolluese, miqësore. Trajneri në të ardhmen do t’i shohë që i kemi bërë dhe së bashku shpresoj se do të përmirësohemi”, ka thënë Zhegrova, i cili më pas ka shprehur

bindjen se përzgjedhësi Franco Foda i ka parë të gjithë lojtarët dhe në shtator do ta bëjë ekipin më të mirë për ndeshjet e Ligës së Kombeve. “Trajneri ka parë të gjithë futbollistët nga ky grumbullim dhe besoj se do të ketë edhe lojtarë të rinj që do të vijnë. Në shtator do ta krijojmë ekipin më të mirë për ndeshjet e Ligës së Kombeve dhe do të mësojmë nga gabimet tona. Dëshira normalisht ishte shumë e madhe që të shënoja, por shpresoj që ndeshjet e radhës t’ia arrij qëllimit. Besoj se kemi ende shumë punë për të bërë dhe duhet të përmirësohemi shumë më shumë”, ka shtuar Zhegrova. Pas kësaj humbjeje ka folur edhe mbrojtësi

Mërgim Vojvoda, i cili ka thënë se Kosova ka luajtur për 60 minuta shumë mirë, por goli i pranuar ka ndikuar në vazhdim të ndeshjes. “Ka qenë një lojë shumë e rëndësishme për ne. Ka qenë ndeshje shumë pozitive. Besoj se kemi luajtur mirë 60-65 minuta, pastaj morëm golin e parë që na rrëzoi për tokë. Do të mësojmë nga këto gabime. Kemi luajtur kundër një kundërshtari shumë të mirë dhe përpos të vazhdojmë me pozitivitet dhe me punë e trajnime stafin e ri, gjithçka është në rregull”, ka thënë Vojvoda. Kosova, përveç humbjes nga Hungaria, nën drejtimin e Franco Fodas, e zhvilloi edhe një tjetër miqësore ndaj Armenisë, të cilën arriti ta fitonte me rezultat 1-0.



‘Ylli i javës’ në Superligë, Basa: Klubi meriton një pozicion tjetër

“Epoka e re”

PRISHTINË, 27 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim për javën e26 në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të SC Gjilanit, Edi Basa. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Milaim Humolli, Naim Kodraliu dhe Muhamet Sylejmani. Ky komision vendosi që çmimi “Ylli i Javës” për xhiron e 26 t’i takojë Edi Bases, i cili shënoi gol të bukur, ku gjatë tërë ndeshjes u shqua për depërtime. Pasi mori këtë çmim futbollisti i SC. Gjilanit u shpreh i lumtur që për herë të parë u vlerësua më i miri i javës. “Jam shumë i nderuar, gjithashtu ky çmim më jep motivim më të madh për ndeshjet e ardhshme. Unë gjithmonë analizoj veten time dhe analizoj edhe skuadrën kundërshtare. Ishte një ndeshje e vështirë për ne, pra ishte një derbi. Megjithatë, ne



gjithmonë japim maksimumin në ndeshje, për lojë, po ashtu, edhe për tifozët tanë. Mendoj se luajtëm mirë. Ndeshja përfundoi 2-2. Mendoj se ishte e përballeshme. Për momentin nuk jam i lumtur me situatën aktuale, sepse klubi

meriton më shumë se pozicionin aktual që kemi. Shpresoj që do të jemi më të fuqishëm dhe do ta japim maksimumin për ekipin, duke bërë kështu tifozët tanë të lumtur”, ka thënë Basa për faqen zyrtare të FFK-së.

SHKURT

Sot mbahet Kuvendi i Punës i FHK-së

Federata e Hendbollit e Kosovës i ka bërë të gjitha përgatitjet për Kuvendin e Rregullt të Punës. Ky kuvend do të mbahet të enjten (sot) prej orës 16:00 në Hotel Internacional Prishtina. Kuvendarët do të shqyrtojnë dhe do të votojnë për raporte të shumta. Fillimisht do të shqyrtohet e aprovohet Procesverbali nga Kuvendi i kaluar. Më pas do të shqyrtohen raporti i punës së bordit për vitin 2023, raporti i pasqyrave financiare, raporti i auditimit, raporti i këshillit mbikëqyrës si dhe plani financiar dhe ai i veprimtimit për vitin 2024.

Ismajli, gati për një aventurë të re

Menaxheri i Ardian Ismajlit thotë se lojtari është i gatshëm për një aventurë të re. Pak ditë më parë mbrojtësi kuqezi u lidh me një kalim të mundshëm te skuadra e Napolit. E menaxheri i tij, Sergio Mezi, thotë se klienti i tij është i gatshëm për hapin para në karrierë. Sipas menaxherit italian, Ismajli përfundimisht do të largohet nga Empoli. Napoli mbetet favorit për transferimin e 27-vjeçarit më të përfunduar edicioni aktual. Por, në garë për mbrojtësin shqiptar janë edhe Genoa e Sassuolo. Ismajli ka kontratë me Empolin deri në vitin 2025. Këtë edicion ka 22 paraqitje në Serinë A, ndërsa është pjesë e Empolit prej vitit 2021 kur iu bashkua nga Spezia.

Hysaj në verë largohet nga Lazio

Në fund të këtij edicioni Elseid Hysaj pritet të largohet nga Lazio. Kështu kanë raportuar mediet italiane, duke bërë me dije se mbrojtësi shqiptar e ka njoftuar skuadrën e Lazios për vendimin e tij për t’u larguar në fund të sezonit. Mësohet se Hysaj ka kërkuar largimin pas dorëheqjes së trajnerit Maurizio Sarri, i cili e transferoi te Lazio nga Napoli. Klubi i Lazios synon ta shesë për 3 milionë euro Hysajn, i cili ka kontratë deri në verën e vitit të ardhshëm. 30-vjeçari këtë edicion ka 22 paraqitje për Lazion në të gjitha garat.

Shaqiri: Gjithmonë më pëlqen të shënoj për Zvicrën

Cyrih, 27 mars - Xherdan Shaqiri ishte vendimtar për Zvicrën, pasi shënoi gol në miqësoren ndaj Irlandës së Veriut (0-1). Ylli nga Kosova ka realizuar një gol spektakolar nga gjuajtja e lirë duke i siguruar Zvicrës një fitore të madhe. “Si ekip vendosëm të fitonim sot.

Shënuam një gol dhe nuk pranua asnjë. Tani mund të shkojmë në shtëpi nga kjo kohë e kombëtares me një ndjenjë të mirë”, ka thënë Shaqiri, i cili ka folur edhe për golin nga gjuajtja e lirë. “Po, gjuajtjet e mia të gjata gjatë nxehtësisë ishin vërtet shumë të mira (qesh). Shpresoja për një

shans për të gjuajtur menjëherë, por nuk pati një të tillë. Më vjen mirë që goditja e lirë shkoi dhe munda të jap një kontribut të rëndësishëm në fitore”, ka shtuar Shaqiri. “30. Një numër i bukur. Gjithmonë më pëlqen të shënoj gol për kombëtaren e Zvicrës. Por nuk ka asnjë festë të

madhe, asnjë festë – për fat të keq më duhet të kthehem nesër”, u shpreh sulmuesi gjilanas. 32-vjeçari ka zhvilluar deri më tani 121 ndeshje me fanellën e Zvicrës që nga viti 2010 kur ka debutuar, derisa përveç 30 golave, ka dhuruar edhe 34 asistime.



Rrëfëhet Messi: Nuk isha përgatitur për t’u larguar nga Barcelona

MIAMI, 27 MARS - Lionel Messi ka pranuar se iu desh ta “rindëronte jetën e tij” pas largimit tronditës nga Barcelona në vitin 2021. Gjithashtu ka nënvizuar vështirësitë e tij te PSG-ja. Largimi i Messit nga Barcelona në vitin 2021 shkaktoi valë tronditëse në mbarë botën e futbollit, pasi sulmuesi argjentinas u nda me klubin, të cilit i ishte bashkuar në moshën 13-vjeçare. Superylli pati një lamtumirë me lot në sy, gjatë asaj konference shtypi të organizuar me nxitim, më pas u nis për në Ligën 1, PSG, ku fillimisht luftoi për t’u përshtatur në kryeqytetin francez. Pas një sezoni të parë zhgënjyes me PSG-në, Messi vazhdoi të shënonte 16 gola dhe dha 16 asistime për klubin e Ligës 1 në sezonin 2022-2023. Messi fitoi dy tituj kampioni me PSG-në, por nuk mundi t’i frymëzonte parisienët drejt triumfit të parë në Ligën e Kampionëve. Për pasojë u kritikua gjatë kohës së tij në Francë. Tetë herë fituesi i “Topit të Artë” më pas u transferua tek Inter Miami dhe është përshtatur shpejt me jetën e ShBA-së, bashkë me familjen e tij, duke u bërë “hit” i menjëhershëm me skuadrën e MLS-së. Messi ka thënë për podkastin e “Big Time”: “Ndryshimi ishte i vështirë kur shkova te PSG-ja,



sepse po bëja shumë mirë në Barcelonë dhe kisha planifikuar të qëndroja atje. Nuk isha i përgatitur të largohesha, gjithçka ndodhi shumë shpejt, më duhej ta rindërtoja jetën nga një ditë në tjetrën. Njoha një ligë tjetër, një klub tjetër, një dhomë të re zhvishjeje. Ishte një ndryshim që nuk e kërkoja, prandaj ishte e vështirë në fillim”. Argjentinas shtoi për karrierën e tij të shkëlqyer në “Camp Nou”, pasi u largua nga vendlindja për ta ndjekur ëndrrën e vet në Evropë, në fillim të adoleshencës: “Për mua ishte e vështirë kur mbërrita në Barcelonë. Isha fëmijë dhe më duhej të përshtatesha me miq të rinj, vend

të ri, qytet të ri, njerëz të rinj, shkollë të re. Ishte e vështirë në fillim, por mendova se po bëja atë që doja, duke luajtur futboll, në një ekip të madh si Barcelona dhe kjo më bëri të aftë të ecja përpara. Gjithçka ishte mbresëlënëse, më ka pëlqyer shumë. Gjithmonë më kanë trajtuar shumë mirë në Barcelonë, u jam të gjithëve mirënjohës”. Messi ka një kontratë me Inter Miamin deri në fund të sezonit 2025, kur do të jetë 38 vjeç. Nuk është e qartë se sa do të vazhdojë të luajë ikona e Argentinës, por ka folur më parë për dëshirën e tij për t’u rikthyer në Barcelonë, tashmë në ndonjë rol drejtuesi, jo më si futbollist.

Lakersat triumfojnë pas 10 minutave shtesë ndaj Bucksit, Golden State mposhti Miamin

MIAMI, 27 MARS - Katër ndeshje të luajtura në NBA dhe katër fitore të skuadrave udhëtuese. Lakersat mposhtën me rezultat 128-124 Milwaukee pas dy kohëve shtesë. Një ndeshje spektakolare nga të dyja ekipet, me lakersat që korrën suksesin e katërt radhazi. Edhe pse pa LeBron Jamesin, ekipi kalifornian bëri një paraqitje të mirë, ku u dallua Davis me 34 pikë e 23 rebounde, mbështetur nga Russell dhe Reaves, me nga 29 pikë secili. Antetokounmpo realizoi një “triple double” për Bucksin (29 pikë, 21 rebounde, 11 asistime), por



që s’mjaftuan. Befason Golden State, që mundi me rezultat 113-92 Miamin në shtëpinë e këtij të fundit. Klay Thompson protagonist për Warriorsin, autor i 28 pikëve, duke i bërë të pavlefshme 24 pikët e

Adebayos për ekipin nga Florida. Skuadra e Dallasit, falë 28 pikëve të Donqiqit dhe 24 të Irvingut, mundi me rezultat 132-96 Sacramenton, duke qëndruar në zonën “play-off”. Oklahoma ngjitet në vendin e dytë në Perëndim pas fitores me rezultat 119-112 ndaj New Orleansit, sfidë ku u dallua Williams me 26 pikë.

REZULTATET	
Miami - Golden State	92-113
Milwaukee - Lakers	124-128
New Orleans - Oklahoma	112-119
Sacramento - Dallas	96-132

Projektohet rikthimi i De Geasit në Madrid

David De Gea qëndron pa skuadër prej verës së vitit të kaluar, kur i dha fund aventurës 12-vjeçare me Manchester Unitedin. Portieri spanjoll nuk arriti të gjente

skuadër të re as në merkaton e janarit, por nuk është demoralizuar dhe po punon për të qenë në gjendje të mirë fizike. Shtypi iberik shkruan se “gardiani”

33-vjeçar mund të firmosë me Realin e Madridit në fundin e sezonit. Kepa Arrizabalaga do të rikthehet te Chelsea dhe “Los Blancos” po mendojnë të firmosin

me De Gean, autor i 45 ndeshjeve me kombëtaren e Spanjës. Gjatë merkatos dimërore u fol edhe për një rikthim në “Old Trafford”, por Andre Onana e ka marrë veten dhe

pista De Gea ra si opsion. Tashmë pritet rikthimi në kryeqytetin spanjoll, aty ku mbrojti portën e Atletico Madridit përpara transferimit në Premierë Ligë.

SHKURT

Ukraina në ‘Euro 2024’, Zelensky: Faleminderit për këto emocione!

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, u shpreh i lumtur pas kualifikimit të kombëtares së Ukrainës në “Euro 2024”. “Faleminderit djema! Faleminderit ekip për emocionet e rëndësishme që i dhatë të gjithë vendit, për fitoren e rëndësishme dhe për kualifikimin në ‘Euro 2024’. Ju dëshmuat sërish, sa herë që ukrainasit përballen me vështirësi, nuk dorëzohen dhe vazhdojnë të luftojnë, ata fitojnë patjetër. Në momentet kur armiku përpiqet të na shkatërrojë, ne demonstrojmë çdo ditë se ukrainasit ekzistojnë dhe do të jetë atje. Ukraina është dhe do të jetë! Faleminderit për fitoren! Lavdi Ukrainës!”, ka shkruar Zelensky.

Giroudi arrin marrëveshje me Los Angeles FC

Olivier Giroud duket se është duke luajtur sezonin e tij të fundit me Milanin. Sipas gazetarit të njohur italian, Fabrizio Romano, lojtari francez dhe klubi Los Angeles FC kanë arritur marrëveshjen verbale për një transferim nga 1 korriku. Pas interesit që në tetor dhe ofertës formale ditët e fundit, duket se ka ardhur edhe aprovimi i Giroudit. Kontrata me klubin e MLS do të jetë e vlefshme deri në dhjetor 2025, por kontrata ende nuk është firmosur.

Goretzka po mendon të largohet nga Bayerni

Leon Goretzka është duke menduar të largohet nga Bayern Muncheni, pasi po humbet pak nga pak terren në formacionin bazë, me drejtuesit që besojnë shumë te Pavloviqi. Lojtari ka një kontratë deri më 2026, kjo është vera e duhur për ta ndryshuar ambientin, menjëherë pas Evropianit. Sipas “Bild”-it: Goretzka është i bindur në këtë pikë, kërkon të ndryshojë ambient, thjesht po pret telefonatën e duhur. Juventus i ndjek nga pranë situatën rreth tij, por Goretzka është një lojtar i shtrenjtë për “xhepat” e “Zonjës së Vjetër”, një futbollist që përfiton 17 milionë euro në vit. Goretzka pëlqehet shumë në Premierë Ligë, ku për të interesohen ekipe si Chelsea dhe Manchester United.

Mourinho: Rikthehem në verë

Jose Mourinho në një intervistë për gazetarin Fabrizio Romano ka bërë me dije se do t’i rikthehet punës së trajnerit në verë. “Dua të rifilloj. Shpesh, kur mbyll një aventurë, të duhet kohë për të menduar, por këtë herë ishte ndryshe. Një ditë pasi u largova nga Roma isha gati të rikthehesha. Ndihej shumë mirë, jam gati, por duhet të jem i duruar pasi jemi në mars, është e vështirë që tani të ndodhë diçka e rëndësishme, pra objektivi im është ta rifilloj në verë”, u shpreh Mourinho, i cili nuk e përjashtoi mundësinë ta punojë në Arabinë Saudite.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime
drejtë përqaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “UNDER CONTROL” Sh.P.K. me seli në Mitrovicë të Veriut, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 810170168 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTEN.JE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “UNDER CONTROL” D.O.O. od Severna Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810170168 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “UNDER CONTROL” L.L.C. with headquarters Mitrovica e Veriut, has come to the decision to quit its business: 810170168 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Taurik Juryshi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.

- Albulena Dakaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.

- Hazer Parallangaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu” Pjeter Budi “ Lubizhde e Hasit.

- Mixhen Ademi shpall të pavlefshme
Diplomën e shkollës së mesme
“Mihajl Grameno” Fushë
Kosovë.festim Qafleshi nga Gjakova
shpall të pavlefshme dëftesat e kl.
10.11.12 të sh.m. Teknike
“Nexhmedin Nixha” Auto Mekanik.

- Dion Milla nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës f.m.u. "Mazllom Këpuska" nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Fatlinda Curri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.


- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme
na kontaktoni në numrin e telefonit:
044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr-it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA 1992

